

FJALIM I EDI RAMËS NË GREQI

Dekurajim i kthimit në atdhe
dhe nxitje për asimilim të shpejtë
të diasporës shqiptare

Nga Artur Shkurti



PARATHËNIE

Në këtë artikull, lexuesi do të gjejë fjalimin e plotë të z. Edi Rama, kryeministër i Shqipërisë dhe Kryetar i Partisë Socialiste, të mbajtur në Greqi, më 12 maj 2024, në Athinë në pallatin e sportit Galatsi, në prani të mijëra shqiptarëve dhe të transmetuar gjerësisht në media.

Sipas meje, ideja kryesore e fjalimit ishte **dekurajimi i kthimit në atdhe** dhe **nxitja e asimilimit të shpejtë të shqiptarëve**, në atë mënyrë që u duk qartë sikur bëhet për një përfitim politik personal të tijin dhe të Partisë Socialise për të patur mbështetjen e Greqisë, Italisë, Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe, të cilat “kërcënohen” me “faktorizim të diasporës”. Në këtë mënyrë ai e lë topin në mes të fushës, që do të thotë se ai nuk po bëhet me interesin shqiptar, por është gjendje të luajë me interesin shqiptar për interes të tijin politik.

Në këtë kuptim ai i meriton plotësisht fjalët e Sami Frashërit:

“Secili është i detyruar t’i shërbejë atdheut të tij pa shpërblim. Nuk është për t’u qortuar ai që i shërben atdheut të tij dhe shpërblehet, por s’ka poshtërsi më të madhe se të rrezikosh atdheun për interesa personale.”

Lënia e qëllim të në mes të udhës e pozicionit të diasporës me synimin që të bëhet “pazar” fati i saj derisa të zgjidhet fati i Edi Ramës mund të jetë e zgjuar, por nuk është kombëtare, është antikombëtare, sepse diaspora lodhet dhe ajo dorëzohet dhe nuk duhet të dorëzohet. Edi Rama e di që do ta lodhë diasporën, ndaj bën një fjalim që s’është as mish as peshk, më zë as më lëshon. Me Kushtetutë çdo qeveritar e ka të ndaluar të ketë një pozicion të tillë “pazari” me diasporën. Ai thjesht duhet të mbrojë interesin e saj dhe jo t’i tregojë “kundërshtarit” se çfarë është i zoti të bëjë. Përgjigjia e Bakojanis se edhe qeveria greke mund të luajë me diasporën shqiptare më fort sesa qeveria shqiptare që përfaqëson Edi Rama tregon se qeveria greke e di saktë që Edi Rama nuk e ka mbrojtur diasporën në miting, por thjesht ka dashur të japë një sinjal që mund të luajë me të. Çfarë është kjo? Dora Bakojanis nuk do ta thoshte atë nëse ajo do të kishte bindjen se vërtetë Shqipëria zyrtare i do dhe ka mundësi t’i tërheqë emigrantët e saj në atdhe.

Naim Frashëri thotë:

*“Mos iu afro dhelpërisë, po së drejtës iu nis pas,
në dëgjofsh fjalët e mia do të jesh gjithnjë në gas”.*

Naim Frashëri e ka treguar me vepra si komunikon mesazhe me grekët dhe shembull më i pastër i kësaj është poema “Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve” (1886, Bukuresht) që e shkroi në greqisht. Lexuesi e gjen të cituar të plotë në fund të këtij artikulli. Edi Rama, përse do të jetë në dorën e tij, i hoqi diasporës shqiptare të Greqisë të drejtën e trashëgimit shqiptar.

Sami Frashëri thotë:

*“Atdheu është trashëguesi i vërtetë i njeriut,
madje edhe eshtrat e tij mbeten atdheut.”*



Artur Shkurti

Drejtor i shkollës “Udha e shkronjave”

Disa botime dhe artikuj me fokus të veçantë në diasporën shqiptare:

Libri “Global Albania - një koncept i ri për diasporën” (prill 2024)

Autor i librit “Besa, feja ime e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë” (2009)

“Projektligj për mbështetjen e arsimit shqip në diasporë nga shkollat publike të Shqipërisë dhe të Kosovës”. (Letër për qeveritë e Shqipërisë dhe të Kosovës - 12 tetor 2022)

“Gjendja e gjuhës shqipe në diasporë - dobësia e kurrikulës (Shqipëri - Kosovë) përshpejton asimilimin” (14 nëntor 2022)

“Financimi i gjuhës shqipe me buxhet familjar - interes kombëtar” (28 nëntor 2022)

“Për krijimin e shoqatës shqipe të mësuesve të Torontos” - një letër për mësuesit e licensuar të Torontos (nënkupto edhe të Kanadasë). (20 shkurt 2023)

Për Edi Ramën nuk pati asnjë rëndësi ky amanet dhe nuk e menaxhon atë në emër të shtetit shqiptar. Ai nuk do të prekë të tilla ndjesi sepse e di që ajo do të ishte një magnet i fuqishëm. Fjalimi i tij iu përkushtua idesë së braktisjes “së bukur” me pikëpamjen “jeni shumë mirë këtu, jeni të barabartë, triumfuat, ia hodhët, Greqia është e juaja (Shqipëria është e imja dhe e socialistëve që më kanë votuar)”.

Megjithëse Sami Frashëri, ideologu i lëvizjes kombëtare, porositi “Krenaria ka shkaktuar prishjen e shumë shteteve dhe kombeve.” kjo nuk e ndalon Edi Ramën që ta bëjë “krenarinë boshe” mjet. Kjo do të thotë se biznesi i krenarisë vijon të ecë, ndërsa kombi menaxhohet të shkojë drejt mbytjes dhe shpopullimi e provon këtë, shitja e diasporës e tregon këtë.

Sami Frashëri:

“Sthurja është një lumë i rrëmbyer që ecën midis popujve dhe i rrëmben popujt që janë mbrojtur me muret e një morali të mirë dhe me anën e një administrimi të mirë i dërgon nëpër grykëderdhje pranë detit ku ato janë të paracaktuar të mbyeten.”

Fjalimi i Edi Ramës në Greqi është pjesë e menaxhimit të mbytjes së kombit shqiptar në ujin e turbullt të përdorimit politik, në këtë rast, në bashkëpunim me qeveritë e Greqisë, Italisë, Gjermanisë dhe të Britanisë së Madhe. Qartësisht duan të paralizojnë diasporën, ta gozdojnë atë të mos lëvizë nga këto shtete, ta futin në kurth dhe të mos merret me punë kombëtare dhe t’ua lërë menaxhimin e Shqipërisë këtyre shteteve dhe të kenë për menaxhues kryetarin e qeverisë Edi Rama dhe për mbështetës Partinë Socialiste. Është e hidhur, por kështu dalin konkluzionet nga vetë analiza e fjalimit. Ndërkohë që Meloni i lë Edi Ramës Italinë për të folur me diasporën shqiptare në Itali e ta frenojë të kthehet në Shqipëri, ajo sjell me mijëra emigrantë nga Afrika. Pse nuk i thotë “Merrni këta shqiptarët këtu dhe i zëvendësojmë me afrikanë”? Nuk e bën sepse e di që janë të trainuar, të kulturuar dhe përgjithësisht me një sjellje shumë korrekte. E di se fqinji forcohet shumë nëse merr emigrantët e kulturuar.

Kjo analizë teksti që do po paraqes këtu është e kombinuar jo vetëm me atë çfarë u tha konkretisht, por me atë që duhej thënë, pritshmërinë prej një kryeministri shqiptar ndaj diasporës shqiptare e nuk u tha realisht.

Edi Rama përdori “teknologjinë” më lartë të mundshme në përpunimin e tekstit dhe përcjelljen e ligjërimit në audiencë që e bënte të vështirë një bilanc racional të vlerave të fjalimit. Më poshtë po japim karakteristikat e kësaj “teknologjie të lartë”:

Për t’i hapur udhën sofizmave të tij, ai veptoi në këtë mënyrë:

Ngacmoi fort emocionet: Kjo e bën të lehtë që dëgjuesi të përfshihet jo në një botë argumentesh të rregullta nga ana formale, por duke shtuar “prej emocioneve” atë që do ai dhe jo atë që po thotë realisht folësi. Edi Rama shpesh e trembte dëgjuesin duke ngritur zërin, përfshihej në urrejtje, ulej në gjunjë, betohej, kujtonte vuajtjet individuale, (për të harruar orientimin kombëtar).

Sulmet personale: Diaspora shqiptare në Greqi është pjesë e kombit shqiptar dhe problemi i saj është thjesht kombëtar. Jo në pak raste Edi Rama e adresoi problemin personalisht (dihej për këtë e kishte).

Selektimi i të dhënave: Kjo është teknika masive që ai përdori në gjykimin e historisë me Greqinë apo në paraqitjen e situatës së emigrantëve në diasporë. Ai tha se emigrantët shqiptarë janë të barabartë me grekët, por janë të barabartë nëse “asimilohen” por nëse nuk duan të asimilohen atëherë ata nuk janë të barabartë. Atëherë Edi Rama i detyron “të barazohen me grekët” duke u hequr mbështetjen nga Shqipëria për arsimin shqip, për mbështetjen e organizatave të tyre. Kur referon Naim Frashërin ai zgjedh vetëm atë që i pëlqen dhe nga e njëjta poemë “Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve” nuk referon problematikën që Naim Frashëri pasqyron kur flitet për grekët dhe që është aktuale edhe sot siç është përpjekjet shekullore të tyre për të deformuar historinë. Vetë fjalimi i Edi Ramës duket sikur është një “narrativë” greke me gojë shqiptare.

Dikotomia e rreme: Një situatë komplekse që ka më shumë se një zgjidhje, më shumë se një interpretim, Edi Rama qëllimisht e redukton sikur është “e bardhë apo e zezë”. Për ta futur publikun në “ngasje kombëtare” me anë të medias dhe vetë organeve greke e paraqiti mitingun “partiak” si një “alternativë të vetme” a thua se po të mos bëhej mitingu i tij kombi shqiptar do të mbytej. Kjo i shërbeu politikës së tij dhe fitoi në mënyrë spekulative vëmendje. Hapja nga Blendi Klosi me fjalët “E kemi patur shumë të vështirë këtë takim” është thjesht një truk për të bërë dëgjuesin të “pranojë çdo gjë që thotë “kryeministri i vendit tim” se kushedi mbase jemi në luftë dhe nuk e dimë. Ky ishte manipulim i pastër i audiencës.

Orientimi i nga një autoritet: Qartësisht shfrytëzoi emrin e Naim Frashërit, të Ismail Qemalit për të bërë një edukim të cunguar, të paplotë në interes të mesazheve propagandistike. Ndërkohë që Naim Frashëri ka thënë për Bubulinën, një mesazh tjetër nga ai i Kryeministrit saktësisht në po atë poemë “Dëshira e vërtetë e shqiptarëve” citoj:

Naim Frashëri për Bubulinën:

*“Të kesh Boçarin, Xhavellën, Miaulin, Bubulinën, E shumë heronj të tjerë, dhe ata të mos përpiqen për ty, Shqipëria ime, po për grekët e Greqinë!
O heronj të paharruar, u munduat kot së koti”*

Edi Rama thotë: “Ku ka shembull më të mirë se heroina legjendare e pavarësisë greke Laskarina Bubulina, e lindur në një burg të Stambollit me prejardhje arvanitase, një luftëtare legjendare e lirisë së Greqisë, e para grua admirale në botë, në krye të një flote ushtarake detare. Tani, kush na ndalon ne që të mos jemi njëkohësisht krenarë, bashkë me grekët, për kontributin që i ka dhënë Greqisë ajo grua heroike me prejardhje nga një familje ku flitej shqip.”

Edi Rama të jetë krenar, por të mos shpërdorjë emrin e Poetit Kombëtar duke dhënë mesazhe krejt të tjera nga çfarë ai ka dhënë në origjinal.

Gabimi i mentalitetit të turmës: Duke shfrytëzuar propagandën përmes medias Edi Rama ia arriti të instalojë mendimin e gabuar se organizimi ishte “kombëtar” dhe jo “politik”. Më vonë u detyruan të thonë që ishte thjesht “partiak”. Diaspora jonë e injoruar thellësisht nga vetë zyrtarët tanë, ka nevojë për t’u identifikuar “kombëtarisht”, ndërkohë që nuk bën analizën se kush është shkaktari. Për të qenë pjesë e grupit të madh “kombëtar” pozicionohen në mënyrë të paarsyeshme me një lëvizje qartësisht “manipuluese” “përçarëse” dhe “dobësuese”. Diaspora nuk e di se nuk është e lehtë të kesh mbështetjen e qeverisë Micotaqi apo të kesh edhe disa qindra mijë euro për të shpenzuar dhe një parti kryesore parlamentare për të fituar këtë pozicion shpërdorues pushteti mbi audiencën.

Shtrembërimi i argumentit oponent: Duke i dhënë ritëm me “inat” me “tonalitet të lartë” me makinacionin “ishte i vështirë ky takim” Edi Rama ia arrin të manipulojë realitetin e debatit, duke shmangur përgjegjësitë e tij dhe argumentin e mendimit oponent. Një shtrembërim kolossal është që tema e bisedës duhet të jetë kjo që zgjodhi Edi Rama. Në fakt, ai shmangu në mënyrë të turpshme edukimin kombëtar të diasporës, përmes kujdesit për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare, përmes investimit për mësuës, programe, shkolla shqipe, frymëzim shqiptar. Kjo është kaq e vërtetë se kur u thua sot argumentin e shkollës shqipe që është argumenti më i fuqishëm kur flet për çështje të diasporës shqiptare, mund të të kthehen “po ç’rëndësi ka kjo” që do të thotë se Edi Rama e ka bërë dëmin edhe në këndvështrimin që imponon dhe ai e di se e ka gabim atë dhe po i shërben “asimilimit”.

Pasoja të paverifikuar: Fjalimi i Edi Ramës është qëllimisht rëndues, a thua se ishim në fund të greminës dhe diçka duhej bërë shpejt. Kjo ishte abuzive. Shpikja e problemit me Bejlerin është pikërisht për ta futur opinionin në një proces mënjanimi të shqetësimeve të tyre dhe monitorimin e një problemi që vetë autorët e dinë që është “fiktiv” dhe duan të justifikojnë veprime të mëtejshme.

Rreth vicioz (rretho) dhe sofizma: Edi Rama përdor në mënyrë sofiste konceptin “odise”. Odiseja u kthye në Greqi me mundime. Emigrantët shqipëtarë vajtën në Greqi me mundime. Atëherë emigrantët shqiptarë kanë mbyllur një “odise” në mundimet e tyre duke u rehatuar më në fund në Greqi. Në fakt, përdorimi korrekt i termit “odise” është kthimi në “atdhe” dhe jo vajtja në Greqi. Shqiptarët e diasporës e mbyllin “odisenë” nëse kthehen në atdhe dhe jo nëse rrinë në Greqi. Ky sofizëm është me pasoja në interesin kombëtar.

Apelimi ndaj traditës: Meqë është bërë një zakon thuajse i bezdisshëm Edi Rama nuk nguron ta ripërdorë “krenarinë” meqë shumë shqiptarë nuk mund të rrojnë pa qenë “krenarë” edhe kur kjo qartësisht nuk u sjell ndonjë dobi.

Periudhat qëllimisht të gjata: Karakteristikë e kësaj “teknologjie” është “të folurit” në atë mënyrë që pa u thënë realisht diçka, të nënkuptohet sikur u tha, kur nuk është thënë. Duhet të ketë metodologji për këtë. Për ta bërë të mundur këtë, ai përdor qëllimisht fjali shumë të gjata. Lexuesi e ka të vështirë të mbajë ekuilibrin e të kuptuarit të konstrukteve të tilla dhe në vend të analizojë realitetin e fjalimit, dhe deduksionet logjike që dalin, analizon pritshmëritë e tij që i identifikon sikur janë ajo që u tha realisht, pra dëgjuesi gradualisht përfshihet në gjendje halluçinante pa lidhje me çfarë konkretisht po thuhet në fjalim.

Forma e komunikimit (jo të shkruar): Fjalimin e Edi Ramës nuk e gjen të shkruar online dhe kjo nuk është e ndershme. Njerëzit e kanë të vështirë ta marrin mesazhin prej videos. Sidoqoftë unë e shkruajta vetë të gjithin dhe lexuesi e gjen këtu.

Për të provuar sa u tha më lart unë po e sjell këtu 100% fjalimin e tij dhe ndërkohë po komentoj. Fjalimi para diasporës shqiptare në Greqi është një guxim e përgjegjësi shumë e madhe. Edi Rama dhe Partia Socialiste e kanë marrë përsipër duke parë suksesin e sistemit të tyre të propagandës së tyre në atdhe. Këtë radhë duket se bashkëpunëtorë janë edhe qeveritë e Greqisë, Italisë, Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe. Që shqiptarët kanë mbetur pa udhëheqje reale shpirtërore kjo kuptohet fare lehtë dhe faji është pikërisht se lufta bëhet e fortë për të sabotuar inteligjencën shqiptare.

Naim Frashëri i lutet kështu Zotit:

*“Tregomu dhe shqipëtarëve
udhën e punës së mbarë,
bashkomi, bëmi vëllezër,
edhe thjesht shqiptarë”*

Aksioni i Edi Ramës dhe Partisë Socialiste kërkon t’i japë një goditje përfundimtare kombit duke dalë nga “karantina” ku duhet të jetë drejt e në diasporë. Na çudit ky guxim.

Do të provohet në këtë artikull nga analiza e fjalimit të tij dhe nga realiteti i investimit shtetëror në diasporë që **mesazhi kryesor është dekurajimi i kthimit në atdhe dhe nxitja e asimilimit të përshpejtuar** në favor të këtyre shteteve (Greqi, Itali, Gjermani, Britani) që humbin jo pak nga tërheqja e diasporës së kulturuar shqiptare dhe për të dobësuar konkurrencën politike në Shqipëri që rritet nëse vjen diaspora në vend dhe mbajtjen e Shqipërisë në pozita ende të dobta. Këto shtete humbin shumë nga tërheqja e diasporës së kulturuar shqiptare dhe Shqipëria fiton shumë nëse diaspora kthehet. Ndaj misioni “me leverdi politike” është sabotimi i këtij misioni kombëtar për tërheqjen e diasporës në atdhe.

Fjala e Edi Ramës në Greqi ia vlen të analizohet fjalë për fjalë. Fjala do të citohet 100% prej meje që të shmang çdo vërejtje përë moscitim të saktë.

Një nga marifetet dhe dëmet e qëllimta të organizuesve para se Edi Rama të mbante fjalimin, është dhënia e idesë se ky miting ishte i vështirë për t’u organizuar dhe pati pengesa. Kjo shërben për të dekurajuar diasporën shqiptare nga organizimet pas mitingut me mendimin “kur nuk na lanë ne, ju nuk ju kanë për gjë nëse organizoheni”. Nëse realisht do të kishte patur pengesa ato nuk duheshin thënë, sepse kjo thjesht do të trembte diasporën në Greqi dhe i bënte organizatorët reklamues të shtypjes. Vështirësitë u dhanë me mendimin që ju nuk duhet të provoni të lëvizni pa ne të Partisë Socialiste në Greqi. Kjo u bë edhe me mendimin për t’i hapur oreksin dëgjuesit dhe për të ulur vigjilencën e tij, për të hetuar nëse ato që thuheshin ishin apo jo interes i vërtetë shqiptar i Shqipërisë, apo ishin thjesht interes i Greqisë.

Në fakt, do të provohet se thuajse 100% e fjalimit ishte një interes shumë i lartë grek.

SHËNIM I RËNDËSISHËM PËR POZICIONIMIN TONË

Për publikun arsimit është një këndvështrim i dobët i zhvillimit të kombit. Në konceptin e shqiptarit të zakonshëm shkolla është diçka rutinë. Në fakt, shkolla nëse është e vetëdijshme dhe vërtetë kombëtare ka lidhjen më të fuqishme me temën që po trajtojmë. Kjo na jep shumë përparësi në analizën e çështjes së diasporës. Siç mund të vihet re, këtu vërtetë ndodh një çudi që një drejtor shkolle të futet në këtë “lojë politike”. Në pamje të parë duket si politikë, por është krejt tjetër gjë është “shpalosje e profesionit” në thellësinë e gjerësinë e tij. Por mësuesit, pedagogët megjithëse janë “brena arsimit” nuk kanë patur mundësinë ta menaxhojnë plotësisht produktin, sepse u mungojnë shumë shumë të dhëna për të dalë në konkluzione. “Udha e shkronjave” i ka patur këto mundësi sepse ka 27 vjet në arsim, është organizatore e Olimpiadës Kombëtare më masive në Shqipëri dhe prej 22 vjetësh dhe ka rezultate shumë të larta në edukimin kombëtar. Kjo na lidh menjëherë me thelbin e shqetësimit të diasporës: “Si të mbetemi shqiptarë në gjuhë, në kulturë, në orientim”. Kjo është saktësisht çështje shkolle dhe saktësisht jashtë “kompetencës së politikës”, që është mësuar të mos marrë e të shpërfillë diturinë që vjen prej shkollës. Kjo ka edukuar jashtëzakonisht keq edhe publikun shqiptar. Një gjë të tillë ne nuk e gjejmë në Greqi, ku shkollimit kombëtar i jepet një rëndësi e jashtëzakonshme. Ndaj lexuesi të mos e mbajë mendjen tek “politika” (kemi apo s’kemi të drejtë të shprehemi) sepse do të humbasë një këndvështrim që nuk e gjen dot në politikë as në media. Këndvështrimi ynë është thellësisht profesional. Lexuesi ta lexojë me këtë këndvështrim dhe atëherë do të kuptojë vërtetë se çfarë shkruajmë është krejt e pastër dhe jo rënie në politikë (ashtu si kuptohet kjo negativisht).

Synimi i librit “Global Albania - koncept për diasporën” (Artur Shkurti, prill 2024) është krijimi i kushteve të favorshme që kombi ynë përmes organizatave të prodhojë një opinion publik. Lexuesi të lexojë librin “Global Albania” që e gjen pa pagesë në faqen e shkollës “Udha e shkronjave”.

FJALIM I EDI RAMËS NË GREQI

Dekurajim i kthimit në atdhe dhe nxitje për asimilim të shpejtë të diasporës shqiptare.
(analizë e fjalimit)

Edi Rama: Mirë se ju gjej në shtëpinë tuaj të dytë në Greqinë fqinje dhe mike. Faleminderit nga zemra për këtë mikëpritje kaq prekëse, në këtë strehë kaq të madhe që ju e bëtë të duket kaq e vogël. Mirëseardhja juaj më emocionon, entuziazmi juaj më përul, po mbi të gjitha, jeta dhe vepra juaj më mbushin me frymëzim shqiptarin dhe me shumë krenari për ju njerëz të zakonshëm nga të katër anët e Shqipërisë që jeni bërë shembëlltura e jashtëzakonshme e krenarisë së atdheut tonë në këtë pjesë të Europës.

Koment: Shtëpia e dytë apo shtëpia e vetme? Një pjesë e mikëpritjes ishte nga administrata. Kujdesi i Edi Ramës është të japë idenë maksimale të rehatisë e t'u japë idenë e gënjeshtërt se Greqia me numrat e mëdhenj të shqiptarëve nuk është një makineri gjigande bluarëse e asimilimit por i linka shqiptarët të presin e të përcjellin, sikur shteti të ishte i tyre. Frika e të gjitha shoqatave për të qenë organizatore është provë e të kundërtës.

Edi Rama: Disa, këtu në Greqi, u çuditën. Të tjerë u mërzitën. Ndonjë edhe tha se unë nuk duhet të vija për vizitë tek ju, por, kur ta shohin këtë shfaqje gëzimi familjar, ata do të kuptojnë që unë nuk kam ardhur të takohem me shërbëtorët e tyre të dikurshëm, por kam ardhur të çmallej me të zotët e barabartë të kësaj shtëpie. Kam ardhur të flas me qytetarët e barazvlefshëm të Greqisë demokratike në Europën demokratike, ku shqiptarët nuk janë më “të ardhurit e rreckosur nga malet” apo barbarët e dyndur nga detet, por janë përfaqësuesit e një vendi krenar që është Shqipëria jonë.

Koment: Investim në idenë e gënjeshtërt se gjatë këtyre 34 vjetëve nuk ka ndodhur një asimilim gjigand i emigrantëve, por paska ndodhur që këta emigrantë edhe pa u kujdesur për gjuhën shqipe, edhe pa krijuar shoqëri patriotike, edhe pa patur ndihmën e shtetit shqiptar, apo të sistemit arsimor shqiptar, edhe pa patur një edukatë patriotike të mirë paskan arritur të jenë thjesht qytetarët e barazvlefshëm të Greqisë demokratike, ku me nënkuptim, del se ata janë asimiluar pra janë bërë grekë, por imponohet sikur paska qenë një interes e objektiv kolektiv shqiptar, pra e bën asimilimin në Greqi një objektiv kombëtar tonin dhe jo një pasojë negative të emigracionit dhe të paaftësisë së Shqipërisë për t'i mbajtur si shqiptarë.

Gradualisht do të shohim se gjatë gjithë fjalimit tempi i konvertimit dhe i asimilimit mbahet i lartë duke përdorur një gjuhë evazive, për të mos dalë zbuluar. Kryeministri noterizoi faktin që dikur shqiptarët ishin “të ardhurit e rreckosur nga malet” ose “barbarët e dyndur nga detet”. Nëse ai i referohet medias greke, në rastin e parë, atëherë

duhet të pranojë që po i referohet një interesi grek referimi edhe për rastin e dytë, sepse nuk shkon që të parat (i rreckosur e barbar) të jenë të medias greke ndërsa të dytat (përfaqësues të një vendi krenar si shqipëria). Për koherencë të mendimit, duhet ose t'i thotë të dyja kryeministri shqiptar, ose të dyja t'i thotë media greke. Ndryshe kemi gabimin logjik të katërfishimit të termave (të bërjes lëmsh të logjikës) që është e qëllimshme në rastin e propagandës. Në rastin e situatës ku “të dërguarit e rreckosur nga malet” dhe “barbarët e dyndur nga detet” si ishte Shqipëria “krenare” apo jo? Kur e fitoi krenarinë Shqipëria emigrantët ishin brenda saj apo jashtë saj? Ja se çfarë lëmshi e bën qëllimisht vetëm për të transplantuar produkte të propagandës dhe jo produkte të realitetit.

Edi Rama u referohet “disave” grekëve që janë kundër dhe jo të gjithë grekëve apo shumicës së grekëve, që do të thotë me nënkuptim se shumica e grekëve pas takimit e fjalimit të tij do të mendojnë si ai dhe në të vërtetë duhet të mendojnë si ai sepse ai ka ardhur t'ua falë 600 000 emigrantët duke noterizuar asimilimin e tyre, duke premtuar që Shqipëria nuk do të investojë në shqiptarizimin e tyre, nuk do të investojë në arsimin shqip, nuk do të investojë në kthimin e tyre. Greqia e di shumë mirë se nëse shqiptarët ikin nga Greqia drejt Shqipërisë një vrimë e madhe hapet në ekonominë e saj dhe ajo duhet t'i zëvendësojë shqiptarët “e asimiluar” me një racë tjetër, ndërkohë që këta shqiptarë që ikin dinë shumë për Greqinë, për ekonominë e saj, për tiparet më të përgjithshme që ata kanë, pra në rast konkurrence ndërmjet kombeve, ata do të jenë të suksesshëm nëse janë në anën e Shqipërisë dhe po aq do të jenë të suksesshëm ta dështojnë Shqipërinë nëse janë në anën e Greqisë.

Edi Rama: Shqipëria e ka ngritur përfundimisht kokën e ulur në shekuj nga dhuna e historisë së saj tragjike dhe i sheh sot drejt e në sy që të gjithë me të njëjtin respekt që meriton dhe kërkon nga të gjithë.

Koment: Kjo nuk është aspak e vërtetë. Ngritja e kokës ka qenë një realitet i shekullit 19 dhe 20, por Shqipëria e ka ulur kokën dhe mjaft të shihet sabotimi që Shqipëria (nëse kuptojmë qeverinë) i bën Kosovës dhe çështjes shqiptare në përgjithësi, mjafton edhe ky tur i Edi Ramës dhe i Partisë Socialiste që synon që për interesa politike të saj të shesë diasporën në shtetet perëndimore, duke u premtuar këtyre shteteve që ajo nuk do ta kthejë diasporën shqiptare në shtetin e saj, sepse e di që humbjet e këtyre shteteve do të jenë jo të vogla. Me aftësinë e tij për të shitur çdo interes shqiptar dhe për ta shitur këtë shitje si sukses kombëtar fakt është që Shqipëria e ka kokën të ulur edhe më shumë dhe nuk e ka të ngritur.

Edi Rama: Ju shqiptarët e Greqisë, jeni sot një vlerë e shtuar e punës, e ekonomisë, e dijes, kulturës së këtij vendi të bekuar ku qëndron prej 25 shekujsh djepi i filozofisë dhe i demokracisë e me të cilin na lidh jo vetëm fqinjësia por edhe një histori mijëra vjeçare.

Koment: Edhe pse është e logjikshme të bëhen elozhe vendit pritës të emigrantëve, do të shohim se nuk është ky synimi i Edi Ramës. Ai synon të himnizojë asimilimin, synon të investojë në harresën e kthimit në atdhe, synon të justifikojë pse ai nuk ka një program kthimi për emigrantët. Ndaj i duhen fakte pozitive.

Edi Rama: Përgjatë kësaj historie, fatet tona, zakonet tona, shtigjet e jetës dhe rrugët e shtëpive tona, fatet e jetës, luftrat, vallet, këngët, përrallat, marrëdhëniet tona kanë qenë gjithnjë shumë më të lidhura sesa janë dukur apo sesa janë lënë të duken nga retë, mjegullat dhe pluhurat e politikës së dy vendeve tona.

Koment: Vijon sulmi zbukurues i situatës. Edhe pse një analizë objektive është detyrë e studiuesve të dy vendeve, vetë Edi Rama thotë se këtë punë e kanë bërë “retë, mjegullat dhe pluhurat e politikës” dhe kjo duhet të jetë e vërtetë edhe për këtë fjalim, që synon të hedhë pluhur, tym, mjegull mbi realitetin dhe do ta shohim se si, pra edhe fjalimi i Edi Ramës këtë funksion ka, por që ai ia hedh vetëm të tjerëve. Veçse ka një ndryshim që nëse viktimat e propagandës greke janë shqiptarët, në rastin e Edi Ramës viktimat të propagandës së tij do të jenë diaspora shqiptare dhe aspak politika greke, që e ndihmoi të organizonte atë lloj takimi.

Edi Rama: Edhe sot që flasim, dy dekada e kusur pas ikjes së shekullit të njëzetë, dukja e marrëdhënieve tona thotë shumë më pak sesa realiteti, intesiteti, ndërthurja e jetëve dhe ndërlihdja e rrugëve të së ardhmes, pandashmërisht të përbashkët të shqiptarëve dhe të grekëve. Në sipërfaqen e kulturës së shkruar të kohëve të sotme, ku kanalet e informacionit dhe rrjetet sociale i japin fytyrën e politikës së ditës kësaj marrëdhënie të lashtë, duke u ofruar njerëzve suflaquet e nacionalizmit folklorik dhe rakinë e ciklit populist, për t’u ngrohur parqeve elektorale, dhe për të përgjumur trurin qytetar, duket sikur midis Shqipërisë dhe Greqisë ka patur vetëm probleme të përjetshme, ndërkohë, jeta e përditshme mes shqiptarëve dhe grekëve jashtë kafenesë së zhurmshme të interesave afatshkurtra të politikës dhe përtej pasqyrave të saj verbuese mediatike vazhdon në mënyrë normale, aktive dhe produktive.

Koment: Ky koment synon të fshehë realitetin e asimilimit, që ne nuk mund ta themi se është për faj të Greqisë, por është për faj të mosinvestimit të Shqipërisë, për shkak të braktisjes së Shqipërisë. Duke qenë se Greqia ka një interes më të lartë asimilues sesa çdo shtet tjetër ku ndodhet diaspora shqiptare, sepse thuhet që mban rreth 600 000 shqiptarë, atëherë është Greqia që investon që shteti shqiptar të jetë i dobët në politikën e tij ndaj diasporës, sepse nuk do të kishte kuptim, nuk do të ishte koherente dhe e pranueshme, që Shqipëria të investon-

te në ndonjë diasporë tjetër, ta zemë në Itali dhe të mos investonte në Greqi. Atëherë lufta e Greqisë në politikën e Shqipërisë është të sabotojë aftësinë e saj për të punuar me diasporën dhe ky fjalim i Edi Ramës është saktësisht kjo dhe Edi Rama e di se çfarë favor i po u bën shteteve dhe kërkon që kjo të mos kuptohet se ai po e bën. Ai nuk dëshiron të ketë një program kthimi sepse programi i kthimit do ta detyronte analizën e fuqishme të diasporës që kulturuar shqiptare ndaj shtetit që ai ka ndërtuar në Shqipëri. Për ta shmangur këtë analizë ai paraqitet në diasporë që të prishë sa më herët që të mundet aftësinë e saj për të reflektuar e qetë.

Lexuesi të vërë re që Edi Rama përdor struktura të rënda gjuhësore, qëllimisht të gjata, ku njeriu harron se cila ishte kryefjala sepse ajo qëndron shumë larg foljes dhe është e mbushur me tofjalësia me nga 10 përcaktorë që janë të rëndë për t’u përtpur se harrohet se cila ishte fjala bërthamë. Kjo e vë në gjumë logjikën, dhe vë në funksion halucionacionin ku lexuesi ose dëgjuesi kujton se Edi Rama është duke thënë atë që ai mendon, kur në fakt, realiteti është krejt ndryshe. Ndaj ka shumë rëndësi që jo ta dëgjojë fjalimin, por ta ketë të shkruar.

Edi Rama: Eksportet shqiptare në Greqi vitin e shkuar u rritën me ¼ më shumë sesa viti paraardhës, ndërsa në muajt e parë të këtij viti Greqia renditet e treta në listën e partnerëve tregtarë të Shqipërisë. Falë angazhimit të vetë operatorëve ekonomikë këtej dhe andej kufirit, jemi në hapat e fundit të krijimit të dhomës së parë shqiptaro-greke të tregtisë dhe industrisë me seli në Athinë.

Koment: Ky fakt mund të thuhet, por konteksti është që duke u dhënë sukseset e biznesit Shqipëri - Greqi, ai po stabilizon në psikologjinë e tyre nënshtrimin ndaj psikozës së paraqitjes së tyre si grekë, pra për “ju që jeni këtu në Greqi po shtojmë vëllimin e biznesit ndërmjet dy shteteve”. Pra argumenti luan me dy porta, ku njëra portë është “rehatimi me identifikimin si qytetarë grekë”.

Edi Rama: Falë nxitjes së njerëzve të ndriçuar të këtij komuniteti në Greqi janë bërë të gjitha gati dhe pritët vetëm miratimi i Qeverisë Greke për të hapur Qendrën e Kulturës Shqiptare për të cilën Qeveria Jonë ka lëvruar edhe fondet përkatëse.

Koment: Qendra e Kulturës Shqiptare do të jetë një mënyrë e dezinformimit të historisë së Shqipërisë dhe marrëdhënieve shqiptaro-greke. Nëse lexuesi do shembuj, mundet të japim tjetërsimin e Muzeut Kombëtar të Arsimit “Mësonjëtorja e parë shqipe” në Korçë ku për interesa të lobit filogrek iu hoq emri Mësonjëtores nga godina, iu hoq statusi Muze Kombëtar i Arsimit dhe u hoq mundësia që 7 marsi 1887 të caktojë Festë Kombëtare. Në vend të saj me nxitim u vu një datë tjetër më e parëndësishme nëse krahasohet me 7 marsin. U vu 22 nëntori 1908 (Kongresi i Manastirit). Është plotësisht e mundur që Qendra e Kulturës Shqiptare të jetë në shërbim të asimilimit grek me financim me ide “krijuese” shqiptare.

Edi Rama: Falë kërkesës në rritje të jetës reale të popujve që jetojnë jashtë gotës së furtunave politiko-mediatike, numri i udhëtarëve që lëvizin drejt të dyja vendeve është dhjetëfishuar. Shqiptarët janë prej kohësh të dashuruar me brigjet e magjshme të Greqisë, por, anasjelltas, gjithnjë e më shumë grekë po zbulojnë Shqipërinë turistike ku ndihen si në shtëpinë e tyre të dytë. Grekët kanë qenë, janë e do të jenë gjithnjë të mirëseardhur në Shqipëri, jo vetëm për të pushuar, por edhe për të punuar, për të hapur dyqane, për të ngritur kompani, për të startuar linja investimesh dhe për të përfitur nga një regjim taksash shumë më i ulët se këtu në Greqi.

Koment: Edhe pse e di që në Greqi janë 600 000 shqiptarë, që presupozohet se do të jenë natyrshëm të interesuar për investim në Shqipëri ai ua bën ftesën në cilësinë e “grekërve”.

Edi Rama: Madje, Shqipëria është kaq mikëpritëse për grekët sa nuk i krijon asnjë telash, përkundrazi i krijon të gjitha kushtet edhe ndonjë politikani të keqkuptuar grek që vjen të protestojë atje, pastaj vjen humb zgjedhjet këtu. Bujrum, si në shtëpinë tuaj. Ju, shqiptarët e Greqisë, jeni dëshmia më e madhe më e fortë, më e bukur e kësaj ndër lidhjeje me miliona fije të pakëputshme të fateve në histori dhe në përditshmërinë e dy popujve, ashtu sikundër janë grekët shqiptarë grekët shqiptarë të minoritetit grek në Shqipëri, qytetarët shqiptarë të minoritetit grek në Shqipëri, në thesar i vyer i shoqërisë sonë, e cila funksionon sot brenda brenda një kornize garancish ligjore për minoritetet që, defacto, e bën Shqipërinë një ndër shembujt më përparimtarë në këtë drejtim, mes të gjitha vendeve të Këshillit të Europës. Ata, grekët e Shqipërisë, kanë halle, kanë probleme, pa diskutim. Ne duhet, e do të bëjmë ende më shumë për ta, por e vërteta e madhe jashtë fushës së vogël të lojrave politike, me topin katror ballkanik është se asnjë hall a një problem i tyri nuk është i ndryshëm nga hallet e problemet e të gjithë qytetarëve shqiptarë. Në një vend si i yni që përparon përditë, po ku plagët e trashëgimisë negative të së shkuarës së afërt e të largët janë ende jo plotësisht të mbyllura, ama, kurrë, asnjëherë, në asnjë rast, një grek etnik në Shqipërinë e të paktën dhjetë viteve të fundit nuk ka patur asnjë hall apo problem për shkak të kombësisë së tij. Kurrë, asnjëherë, në asnjë rast, grekëve etnikë nuk është mohuar arbitrarisht nga shteti shqiptar e drejta e tyre e besimit, e drejta e tyre e gjuhës, e drejta e tyre e pronës. Kurrë, asnjëherë, në asnjë rast, qytetarëve grek të Shqipërisë nuk u është mohuar nga shteti shqiptar e drejta e votës apo e drejta e zgjedhjes për shkak të origjinës së tyre etnike. Dhe, nëse flasim për pronat, këtu ju jeni përfaqësia kombëtare e Shqipërisë. Nga Tropoja në Konispol, nga Shkodra në Korçë, nga Dibra në Durrës, e kush nga ju që ka një shtëpi apo një tokë në ato zona ku ende nuk është bërë shpërndarja e titujve të pronësisë për një mijë e një arsye mund të thotë të kundërtën që ky problem është një problem i Shqipërisë dhe nuk

është një problem vetëm për grekët e Shqipërisë. Që të kërkosh e të zbulosh raste të tilla duhet të gërmosh në qerthujt më të errët të kulturës nacionaliste ku nuk ka asnjë kufi mes historisë dhe miteve, fakteve dhe paragjyqimeve, dokumentave zyrtarë dhe artikujve të porositur.

Koment: Problemin nuk e kanë grekërit, por i kanë shqiptarët. Janë shqiptarët ata që zhvishen nga kultura kombëtare.

Edi Rama: Shqipëria nuk ka asnjë pretendim tjetër ndaj Greqisë përveç respektit reciprok, kujdesit reciprok për bashkëkombasit që jetojnë në të dy shtetet tona, marrëdhëniet reciproke të miqësisë dhe të fqinjësisë së mirë, dhe, jo vetëm kaq, Shqipëria e sheh Greqinë si një partner të natyrshëm strategjik, qoftë për çështjet për t'u zgjidhur mes nes, qoftë sfidat e mëdha të kësaj epoke të re mundësisë por edhe kërcënimesh për Ballkanin, Europën, botën demokratike, ne i shohim si arsye madhore për t'u afruar më shumë, për t'u njohur më mirë, për të mos i bërë bisht asnjë nevojë për më shumë komunikim, për të gjetur zgjidhjet më të arsyeshme për të dy palët për t'u projektuar bashkarisht në të ardhmen, duke ushqyer pa ndërprerje besimin tek njëri-tjetri dhe duke forcuar në çdo hap lidhjet me njëri-tjetrin e, mbi të gjitha, ne besojmë se kompleksiteti i marrëdhëniet tona në këto kohë sfidash globale dhe lokale nuk mund të jetë kurrësesi një shtysë për t'u mbytur në çdo lugë uji që sjell përditshmëria e politikës në oborrin e bashkëjetesës sonë. Jo! Ky kompleksitet duhet të jetë një nxitje e madhe që grekët dhe shqiptarët të binden përfundimisht dhe reciprokisht që fatet tona janë të pandashme dhe, ata të cilët marrin përsipër t'i përfaqësojnë shqiptarët dhe grekët të binden përfundimisht se nuk mund t'i gjejnë përgjigjet për të ardhmen tek e shkuara, por tek e sotmja e fateve të lidhura të grekëve të Shqipërisë me shqiptarët e Shqipërisë dhe të shqiptarëve të Greqisë me grekët e Greqisë.

Koment: Harresa shqiptare për të pretenduar çfarë është e tyrja është duhet të jetë një lëshim i shumë shumëvlerësuar nga grekët që bëjnë sikur nuk e kanë mendjen. Më tutje në fjalim, Edi Rama thotë se ka një ligj të luftës në Greqi. E shoqëruar me çfarë thotë këtu sipër i bie që ai këtë fakt të ligjit të luftës e ka thënë se nuk ka patur nga t'ia mbajë nëse do të donte të dukej se retorika e tij ishte “afër nacionaliste”, por në fakt, ai nuk i kërkon asgjë Greqisë në këtë drejtim, sepse në ligjëratë të drejtë thotë “Shqipëria nuk ka asnjë pretendim tjetër ndaj Greqisë përveç respektit reciprok”. Nuk ma merr mendja që Greqia të ngelet e pakënaqur nga ky noterizim i së shkuarës në favor të saj.

Çfarë thotë Edi Rama është për të ardhmen. Grekët nuk duan pretendime për të shkuarën, por për të ardhmen, nuk e ka problem që “shqiptarët” ta mbushin me dëshira. E shkuara është problem dhe fakt, jo e ardhmja. Fjalja “nuk mund t'i gjejnë përgjigjet për të ardhmen tek e shkuara” është noterizim i lëshimeve ndaj Greqisë.

Edi Rama: *Ju, vëllezër e motra, erdhët në këtë djep të civilizimit të vjetër të Greqisë së lashtë për t'i ikur gërmadhave të regjimit komunist dhe mallkimit të tij të varfërisë më ekstreme. Kapërcyhet malet, fjetët nëpër parqe, nëpër kisha, nëpër stola rrugësh, dolët pa dalë drita për të pritur nëpër sheshe, si kuajt në pazarin e gjësë së gjallë. Afendikojtë që iu merrnin për një punë të zezë krahu, gjakosët duart dhe dërrmuat kurrizin me punët më të rënda, u përballët me gjithëfarë shprehjesh brutale të arrogancës së fqinjit të pasur, ndaj komshiut të varfër, bëtë nga dy apo tre punë, në ditën që nuk mbaronte, duke e zbutur urinë me një pjatë në ditë, për të vënë mënjanë lekët e dy vakteve të pangrëna, përjetuat poshtërimin e fshesave të zeza të fundshekullit 20, kur ju shkullnin nga shtëpitë, me rrobat e trupit nëpër natë për t'iu deportuar në Shqipëri, si në një film trill të një kohe shumë të vjetër të shpërnguljeve me përdhunë të paraardhësve tanë nga shtëpitë e tyre në veriun e Greqisë.*

Koment: Çështjen e Çamërisë e ka fshehur në fund të një paragrafi shumë të gjatë që nuk kishte temë vetë Çamërinë, por operacionet “fshesa”. Le ta sjellim edhe një herë konstruktin e fjalisë.

Edi Rama: *“Përjetuat poshtërimin e fshesave të zeza të fundshekullit 20, kur ju shkullnin nga shtëpitë, me rrobat e trupit nëpër natë për t'iu deportuar në Shqipëri, si në një film trill të një kohe shumë të vjetër të shpërnguljeve me përdhunë të paraardhësve tanë nga shtëpitë e tyre në veriun e Greqisë”.*

Koment: Pra e ka pjesë të një krahasimi, gjymtyrë krahasuese dhe jo temë më vete dhe kjo do të thotë se po e noterizon, si një fakt, të së shkuarës për të cilin ai nuk ka koment, por thjesht mund ta përdor si pjesë të një krahasimi për çështje të tjera. Ndërkohë edhe ka shkruar fjalën “si një film trill të një kohe shumë të vjetër”. Tani ajo koha e vjetër është “reale” apo është “film trill”. Mendoni se si e ka fundosur këtë çështje. Paralelizmi i fshesës greke ndaj emigrantëve me përzierjen e çamëve etnikë nuk është në rregull. Emigrantët janë të ardhur, ndërsa çamët nuk ishin të ardhur.

Edi Rama: *Shumë prej jush ndërruat emrat që ju kishte vënë nëna dhe baba për të marrë dokumentat e punë e regjistruar fëmijët në shkollë.*

Koment: Nuk ka ndonjë koment për Greqinë që e ka bërë detyrimin, por thjesht tregon vendimmarrjen e refugjatit.

Edi Rama: *Ju, shqiptarët e Greqisë, e patë fëmijën të mbytej në lot se kishte dalë më i miri në shkollë, por nuk iu dha e drejta e ceremonisë së flamurit, dhe faji i fëmijës ishte se kishte ardhur nga foleja e shqipes dykrenare dhe nuk kishte lindur nën mbrojtjen e kryqit të bardhë (ovacione), por ja ku jeni.*

Koment: Qartësisht luan kot me ndjenjat, sepse refuzimi që i kanë bërë grekët, megjithëse ksenofob, nga një anë ka edhe të mirën e vet,

sepse i kanë kujtuar fëmijës dhe familjes që nuk duhet të harrojnë që janë shqiptarë. Fëmija është mbytur në lot ngaqë me sa duket e ka dashur atë pozicion si ai dhe familja, pra kanë dashur të bëhen grekë, të sillen si grekë, dhe nuk janë pranuar si të tillë dhe kur kanë dashur të kthehen pas, kanë kuptuar se mund ta kenë urryer qenien shqiptarë dhe kështu kanë mbetur në mes të “katër rrugëve të identitetit”. Nëse familja do të kishte një identitet të fort shqiptar, nuk do të kishte patur lot, por thjesht mund të kishte ndonjë koment tjetër, madje, e mundur ishte që ta kish refuzuar edhe shqiptari e t’u thoshte “Ky është flamuri juaj dhe jo i imi ndaj le ta marrë një shok apo shoqe tjetër e klasës këtë mundësi”. Kështu funksionon identiteti i saktë.

Edi Rama: *Ju shqiptarët e Greqisë nuk u dorëzuan kurrë dhe triumfuat sepse ju jeni gjaku dhe shpirti i një kombi që çfarë nuk pa dhe çfarë nuk hoqi në këtë qiell, por asnjë fuqi apo padrejtësi e kësaj bote nuk e zhbëri dot nga faqja e këtij dheu.*

Koment: Hiperbolat janë të qëllimshme për të maksimalizuar rezistencën individuale të refugjatit “pa komb” dhe për ta “zbukuruar” atë sikur të ishte tipar kombëtar. Kjo do t’i paraprijë konkluzionit “boll tani se u lodhët” dhe “rrini rehat” se ia arritët. Fan Noli tek “Maratonomaku” do të shkruante:

*Ja arrive, ua the,
Ç’gas e ç’helm qe kjo myzhde.
“E fituam!”, brohorite,
dhe përtokë u përpëlite.
Vdiq, or vdiq!
Vdiqe, or Marathonomak!*

Fjalimi i Edi Ramës, në mënyrë letrare, duket se fsheh një ritëm të tillë tregimtarie me motive greke që nga një anë fsheh Maratonomakun dhe nga ana tjetër Odisenë dhe kështu grekëve u ka dhënë gati hartimin që do t’u jepet fëmijëve shqiptarë që ëndërr kanë patur që ndërsa Odiseja kthehej nga Troja në Atikë, shqiptarët paskan bërë Odise kur kanë vajtur jo nga Greqia në Shqipëri, por nga Shqipëria në Greqi, sepse kështu e ka thënë kryeministri pak më tutje në fjalim (citoj kryeministrin që tha: “Jo vetëm shoqëria greke, pjesa më e madhe e së cilës falë ndjeshmërisë së njerëzve të zakonshëm të këtij populli që janë si dy pika uji me tonin u bë mbështetja juaj qysh në fillim të odisesë suaj heroike në kërkim të ishullit të një jete të re në Greqi”). Pra shoqëria greke që ia ka marrë dorën punës me shtrembërimin e të vërtetave në propagandën e saj është ndihmuar nga kryeministri ynë që të ketë termat e duhura dhe teknikën e duhur të të folurit me ta dhe mundet t’ia arrijë “transplantit të gënjeshtërs”.

Në fakt, triumf për emigrantët do të duhet të quhet që kanë arritur të mbesin gjallë dhe disa prej tyre mund të vijnë në sallë për të bërë ovacione për një analizë që është qartësisht jo e ndjerë, por është thjesht propagandë e llogarit. Asnjë triumf nuk kanë. Thjesht ky triumf propagandë i duhet folësit si noterizim që “këtu jeni mirë, e nuk u duam në Shqipëri” sepse keni triumfuar në Greqi, me fjalë të tjera “boll se u lodhët, bëni pak pushim tani”.

Është qartësisht një interes grek. Greqia i do për vete. Është më mirë të ketë shqiptarë sesa popuj të tjerë. Ndërkohë nuk po u bën asnjë ftesë që t'i marrë në Shqipëri, por ftesën po ua bën filipinasve. Pse nuk i thotë Greqisë "merri ti filipinasit e të marrim ne shqiptarët" ???

Edi Rama: Hap pas hapi, ju dolët nga errësira e mbijetesës si rezidentë të damkosur të këtij vendi në dritën e jetës si qytetarë të barabartë të këtij shteti, me vlerat tuaja të fjalës së dhënë, të punës së mbaruar, të korrektesës ndaj të huajit, ju arritët të mos jeni më të huaj në këtë vend. Ju i bëtë vetes vendin tuaj në shoqërinë greke, duke fituar respektin e punëdhënësit, besimin e fqinjit dhe dinjitetin e njeriut të lirë në një vend demokratik. Ju erdhët, luftuat, fituat.

Koment: Në fshehtësi është duke raportuar sikur të kishte para Marathonomakun apo Odisenë dhe kjo pikturë i duhet që fëmijët t'u thonë prindërve «boll se u lodhët për ne, ja edhe kryeministri yt shqiptar ta tha që ia paskemi arritur». Sikur babai ose nëna t'u thonë fëmijëve «Unë kam pritur që kryeministri të më ftojë ose të më marrë në Shqipëri, por nuk e dëgjova» atëherë fëmijëve sigurisht u hapet punë, ndaj fjalimi i Edi Ramës ka maksimalizuar frenimin e familjes që të dojë të kthehet në Shqipëri, siç është interesi shekullor i gjakut.

Në asnjë çast nuk ndan as faj as meritë as për Shqipërinë e as Greqisë, pra e quan një çështje individuale. I lë dorë jashtë të dyja shtetet, sepse i duhet ta trajtojë si çështje «të drejtash të njeriut». Ai e di se mund ta instalojë në mendjen e emigrantit dashurinë për Shqipërinë dhe nuk e bën, sepse nuk dëshiron t'i tërheqë. Kjo do të thotë se i ka «shitur» në pazar me Greqinë. Me ç'të drejtë i shet, kur qartësisht është një interes kombëtar tërheqja e emigrantëve shqiptarë? Kujdesi për ta në kuptimin e Kushtetutës është kujdes «shqiptar», pra instalimi i «kombëtarizimit» përmes edukimit që realizon mbrojtjen nga «asimilimi».

Gjatë fjalimit, Edi Rama qëllimisht e ngre zërin që të duket sikur është konfliktual me Greqinë, për të fshehur faktin që me mënyrën e arsytimit ai po i bën nder asaj.

Është krejt e pavend të thuhet se "fjala e dhënë" është një tipar për të gjithë diasporën, kur grekët e dinë më mirë se kushdo se disa prej tyre ua kanë ngrënë fjalën jo vetëm grekëve por edhe vetë shqiptarëve dhe bashkëfshatarëve të tyre. Vini re që ai nuk e përdor fjalën «besë» por përdor «fjalë e dhënë». Ka një arsye për këtë. Fjalën «Besë» po e ruan për përpunim ideologjik nga izraelitët, të cilëve u ka dhënë të drejtën që Muzen Hebraik ta quajnë «Besa».

Edi Rama: Dhe mos e harron kurrë: me ligj dhe me zakon **Greqia sot është edhe juaja po aq sa ç'është e vetë grekëve.** Bashkë me grekët ju shqiptarët jeni evropianët e Greqisë. Ju sot keni këtu shtëpitë tuaja, dyqanet, biznese, fëmijët të mirëshkolluar në sistemin arsimor të Greqisë, keni rrethin tuaj miqësor, ku greku e shqiptari nuk dallohen më. Kontributet tuaja në ekonominë greke me punën e ndershme dhe me taksat që i paguani shtetit grek

(ovacione), e ndërkohë ju ktheheni gjithnjë e më shpesh edhe në shtëpitë tuaja në Shqipëri, ku keni mbajtur gjithë këto vite, me ndihmën tuaj të paçmuar financiare, prindërit e moshuar, vëllezërit, motrat, nipat, mbesat dhe keni nisur të investoni sidomos në fshatra kursimet tuaja.

Koment: Përfaqësuesi i organizatave shqipe në Selanik Luan Zyka në A2CNN dha një paraqitje tjetër të situatës në Greqi, pra jo kaq lart sa e bën Edi Rama. Mesazhi i mësipër është në kuadër të noterizimit, legalizimit të asimilimit të diasporës.

Nëse një kryeministër do ta kishte vërtet problem dhe pasojë të parashikuar shpopullimin e Shqipërisë dhe jo një politikë e objektiv shtetëror, atëherë nuk do të fliste kështu por do t'u thoshte pak a shumë kështu:

SIKUR TË FLISTE KËSHTU: "Shqipëria jonë po boshatiset. Sado e mirë të jetë Greqia dhe statusi juaj këtu, është e padiskutueshme që ju nuk jeni në atdheun tuaj, nuk jeni pranë fisit tuaj, e gjakut tuaj dhe trashëgimisë suaj. Do të shkëputet zinxhiri biologjik dhe kulturor dhe ju kjo u dhemb. Ne e dimë. Ne e dimë që kjo do t'ju dhembë shumë, ndaj ejani të diskutojmë se si ju të rregulloheni përsëri në Shqipëri. Tashmë ju jeni edhe më lart sesa kualifikimet që kanë shqiptarët në Shqipëri sepse keni marrë profesione të rralla dhe me siguri do të bëjmë punë më të mira për Shqipërinë. Derisa ju të vendosni, ndiqni kurset e gjuhës shqipe, jepuni fëmijëve kulturë shqiptare, porositini dhe ata të vijnë. Programi i kthimit ka parashikuar një rregullim të shpejtë tuajin në çdo parametër: në shëndetësi, në gjendjen civile, në bashkitë ku ju doni të shkoni." (Artur Shkurti)

Vini re sa larg është të folurit e tij nga kjo mënyrë të foluri. "Udha e shkronjave" ua ka dhënë ambasadave tona programin e shkollave shqipe dhe një pikë e programit ka qenë "Programi i kthimit në atdhe". Ne jemi shkollë që s'kemi asnjë fuqi të tillë shtetërore dhe programin e kthimit në atdhe e kemi dhe ua ndamë shkollave shqipe, duke porositur ambasadat tona, ndërsa Qeveria e Shqipërisë qëllimisht bën sikur nuk kupton që duhet të ketë "program kthimi". Kjo provon se ajo e ka shpopullimin objektiv dhe jo pasojë të reformave që po bën.

Një zyrtar i lartë shqiptar, që me para shtetërore ble dhe siguron një vëmendje kaq të madhe të diasporës, nuk do të vinte për të noterizuar përvetësimin (asimilimin) e shqiptarëve, por do të bënte çdo gjë që kthimi të ishte i madh dhe këtë do ta bënte duke instaluar arsimin shqip dhe shkollat shqipe. Fondet tregojnë gjithçka. Fondet për arsimin shqip në diasporë janë qesharake dhe fondi i mitingut partiak ishte disafish më i madh sesa fondi që shpenzon qeveria.

Lexuesi të vërë re se qëllimisht kryeministri shqiptar paraqet një masë amorfe diaspore shqiptare pa interesa kulturore, pa arritje kulturore. Kjo vjen jo vetëm prej dëshirës së tij për t'i ulur të tjerët e për të ngritur veten. Ai i fut rrylin majave shqiptare në kulturë shkencë dhe art. Asnjë fjalë nëse ka apo jo intelektualë diaspora shqipe në Greqi. Këngëtarja e

famshme shqiptare Entela Fureraj që ka ndërruar emrin në Eleni Foureraj mund të nderonte aty me pjesëmarrjen e saj dhe ajo ka ardhur në Shqipëri e ftuar nga Televizioni Shqiptar. Pse nuk e bind kryeministri që ajo të mbajë emrin e vet dhe kështu ta bëjë shembull në Greqi dhe në botë se çfarë bën kryeministri kur e ka për zemër kulturën dhe identitetin shqiptar?

Komuniteti shqiptar përshkruhet në nivelin më të ulët shpi, dyqane, biznese, që do të thotë se ua hoqi nga pretendimet pjesëmarrjen në nivelet e larta të shoqërisë greke, që janë universitetet, kultura, kërkimi shkencor, politika etj.

E la përvetësimin e gjuhës dhe kulturës greke, sepse po anullos gjuhën dhe kulturën shqipe dhe nuk do të futet në një territor të "minuar". Mirëpo është fakt që shqiptarët e kanë mësuar gjuhën dhe kulturën greke se tregojnë gjithmonë një etje për gjuhët e huaja dhe për kulturën e vendit ku shkojnë. Nga ana tjetër nuk menaxhojnë si duhet të shkuarën. Sikur të futej në këtë drejtim të fjalimit, do ta sillte në absurd diskutimin e tij, nëse e përmendte, sepse ne e dimë që kush është i aftë të përvetësojë kulturë tjetër duhet të jetë i aftë ta bëjë të njëjtën gjë edhe me kulturën e vendit të tij të origjinës. Gjuha dhe kultura greke nuk u ranë nga qielli, por u mësuan në shkollat e Greqisë. Të njëjtën gjë duhet të bënte edhe shteti shqiptar dhe kështu diaspora shqiptare të ishte e gatshme për t'u kthyer në Shqipëri. Mirëpo shteti shqiptar ua dështoi fëmijët, sepse nuk instaloi tek ta përmes programeve shkollore dashurinë për Shqipërinë, gjuhën dhe kulturën shqiptare. Ky ka qenë një proces i qëllimshëm dhe i gjithë fjalimi synon përmes ngritjes së zërit dhe përmes një teknologjie aspak të ndjerë, por më shumë të llogaritur të bëjë makinacione me opinionin publik.

Edi Rama: *Unë e di dhe dua t'juaj them: jo të gjitha dallimet janë sheshuar përgjithnjë për të gjithë. E di që jo gjithnjë gjërat shkojnë si duhet për të gjithë. E di që fantazmat e paragjykimeve dhe hijet e përbuzjes i shfaqet tektuk ndonjëherit përveç ndonjë goje apo ndonjë dore të së shkuarës në rrugën tuaj të hapur me forcën madhështore të shembullit. Por unë di po ashtu që koha juaj, koha e shqiptarëve të Greqisë nuk kthehet më kurrë mbrapsht.*

Koment: Me fjalë të tjera shprehja e kryeministriti "Koha e shqiptarëve të Greqisë nuk kthehet më kurrë mbrapsht" do të thotë "Nuk bëhet fjalë që ju të ktheheni në Shqipëri" sepse ju këtu jeni shumë mirë, po edhe ne atje nuk ju duam sepse ne po përzëmë përsëri nga Shqipëria. Atje në Rinas nuk vemi për të numëruar cili shqiptar largohet nga vendi, por numërojmë cilët turistë të huaj po shkojnë në bizneset turistike që kanë hapur pushtetarët që përzënë shqiptarët nga vendi.

Kryeministri u dha garanci për Greqinë në emër të grekëve, që edhe vetë grekët do të ishin të kursyer në të tillë propagandë qartësisht gënjeshtarë, evazive, me mungesë informacion.

Nga ana tjetër, duke gënjyer për realitetin e mesazheve të pritshme, pra se kush do të përfitonte prej mesazheve, thonë se kemi patur

shumë vështirësi për ta organizuar takimin. Me mesazhe të tilla mirë që nuk erdhën edhe vetë grekërit ta ndiqnin takimin. Është bindja ime që grekët kanë marrë pjesë në hartimin e fjalimit dhe e kanë patur atë para se të zhvillohej takimi.

Edi Rama: *Jo vetëm shoqëria greke, pjesa më e madhe e së cilës falë ndjeshmërisë së njerëzve të zakonshëm të këtij populli që janë si **dy pika uji me tonin** u bë mbështetja juaj qysh në fillim të **odisesë suaj heroike në kërkim të ishullit të një jete të re në Greqi**, po edhe politika greke, vendimmarrësit e këtij vendi sot e kanë të plotë vetëdijen se Greqia ka nevojë për ju njësoj siç ju keni nevojë për Greqinë. Greqia dhe shqiptarët e Greqisë janë bërë të pazëvendësueshëm për njëri-tjetrin. Kush e dyshon këtë të vërtetë, dyshon diellin që ndriçon çdo ditë, ndërsa kush i kundërvihet kësaj të vërtete i bie me kokë pasqyrës ku sheh vetëm veten. (ovacione të kota)*

Koment: Odise quhet rruga e kthimit në atdhe. Ndërsa kryeministri quan Odise kalimin nga Shqipëria në Greqi. Kjo do të thotë se ai e quan Greqinë destinacion final të diasporës shqiptare. Ndërkohë që e vërteta është që diaspora do të zhvillojë "odisenë" nëse ajo do të kthehet në atdhe. Pa një garanci, investim në arsim shqip dhe frymëzim nga qeveria apo klasa politike, nuk ka mundësi që ajo të vendosë të kthehet. Paralelizmi me Odisenë është një "transplant" i turpshëm propagandistik.

Vijon jep garanci në emër të grekëve kur thotë "edhe politika greke, vendimmarrësit e këtij vendi sot e kanë të plotë vetëdijen se Greqia ka nevojë për ju njësoj siç ju keni nevojë për Greqinë". Kjo është e qartë që Greqia ka nevojë për ta sepse faturat janë tepër të larta për Greqinë nëse ata largohen drejt Shqipërisë dhe fitimet e Shqipërisë janë të jashtëzakonshme nëse ata kthehen. Ndaj i gjithë fjalimi i kryeministrit është REKLAMË, REKLAMË, REKLAMË për Greqinë dhe antireklamë për Shqipërinë dhe qeverinë që ai përfaqëson.

Një emigrant me mend në kokë do të thoshte: "Pra, e morëm vesh që nuk na dashke në Shqipëri për Shqipërinë, por na do në Greqi dhe për Greqinë".

Kryeministri bën sikur debaton me "mullinjte e erës" sespe askush nuk po ankohet që Greqia nuk ka interes. Ankesat janë që pse Shqipëria nuk tregon interes, kur e ka kaq të lehtë marrjen e tyre. Diaspora shqiptare mund të mos dijë se ku tjetër të shkojë në Greqi, por ama e di saktë se ku duhet të shkojë në Shqipëri. Aty ka fisin, aty ka gjakun, aty ka të afërmit, aty ka shqiptarët.

Edi Rama: *Miqte e mi, kufijtë ndërmjet vendeve tona kanë qenë gjithmonë kufij politikë që elita të caktuara, rëndom të fantaksura, i kanë vënë për qëllimet e tyre aspak të larta, herë për të ushqyer delirin e madhësisë provinciale, duke ndalur me dhunë kohën e popujve, herë për ta treguar dashurinë ndaj atdheut të tyre duke ushqyer urrejtjen për atdheun e të tjerëve, herë për të pompuar muskujt e pushtetit të tyre, kundër rivalëve të brend-*

shëm, duke krijuar probleme të jashtme, por asnjëherë, fatkeqësisht, asnjëherë duke llogaritur dëmet e shanset e humbura nga ndarja e dy popujve të rritur qysh në agimin e njerëzimit pranë e pranë si dy fëmijë në të njëjtin oborr. Prandaj dhe asnjëherë kufijtë politikë mes dy popujve tanë nuk kanë qenë kufij shpirtërorë, jo vetëm se shpirti i popujve nuk njihet kufij, por edhe sepse asnjë ndarje artificiale nuk e zhbën dot një të vërtetë të madhe të rëndë historike e cila është e shenjuar në kujtesën tonë të përbashkët kolektive dhjetra shekuj me radhë. Kjo e vërtetë është se kultura jonë e përbashkët mesdhetare e ballkanike është plazmuar shumë kohë përpara sesa të lindnin shtetet tona.

Koment: Kryeministri hap një front tjetër të kotë diskutimi që i lejon ta ngrejë zërin. Në fakt, kufiri nuk është më i lartë nga Greqia për diasporën, sesa është nga Shqipëria. Atë kufi të moskthimit në Shqipëri nuk e ka ngritur Greqia, por e ka ngritur Shqipëria. Greqia ndjek një politikë të saj nacionaliste dhe është krejt e natyrshme që ajo ta bëjë këtë dhe kjo kështu duhet të funksionojë për çdo shtet. Problemi është që Edi Rama ua ka vënë kufirin e lartë të kthimit dhe ky mur e ka emrin mungesë e shtetit ligjor në Shqipëri, mungesë e dëshirës që emigrantët të kthehen, mungesë investimi në arsimin shqip të fëmijëve, në mënyrë që ata të asimilohen në gjuhën greke dhe të mos kenë mundësi të kuptojnë mesazhet që u thuhet në gjuhën shqipe dhe të hyjnë pastaj fëmijët në konflikt me prindërit. Edi Rama dhe Partia Socialiste e di këtë gjë dhe guxon dhe u fyen emigrantëve logjikën. Emigranti e ka të thjeshtë gjykimin duke shtruar pyetjen “Na doni apo nuk na doni? Kaq.” Po të na doni, merret vesh se si duhet ta kuptojmë. Një shtet i korruptuar nuk e do emigrantin sepse ai vjen tepër i kualifikuar nga shtete demokratike në çështje të respektimit të ligjit dhe nuk pajtohet si qytetari shqiptar me shtypjen.

Edi Rama: *Modeli i qytet-shteteve helene është shtrirë nga Athina në Sicili, nga Anatolia në Durrës, shumë kohë më para se grekët e sotëm të identifikoheshin si grekë apo shqiptarë e sotëm si shqiptarë, në kohëra kur historia ishte histori qytetesh e elitash qendrash urbane, rrjetesh komunikimi, tregtie, diplomacie, prandaj edhe kush sot i qaset djepit tonë të përbashkët të historisë në këtë pellg gjeografik shtresash, epishtresash historiko-kulturore, me kategoritë dhe kufizat e sotme jo vetëm e ka të vështirë pastaj ta shmangë kapadajllëkun ballkanik të tipit “kush jemi ne, kush jeni ju”, po është një hap larg rënies në gropën e privimitivizmit nacionalist, ku gjallojnë sot e gjithë ditën, mes dhe brenda nesh, gjarpërinjtë e luftrave, konflikteve, sherreve, ndasive, të cilët na kanë pickuar, helmuar, përgjakur, rrëzuar dhe penguar, shumë herë përgjatë rrugës sonë të përbashkët dhe të pandashme, si shqiptarë dhe si grekë. Më lini t’ju jap një shembull, një shembull shumë të thjeshtë, ndër dhjetra, qindra, mbase mijëra. Mosmarrëveshjet mes oligarkëve të Epidamit, Durrësit sot, përmenden nga Tuqiditi, si një nga shkaqet e fillimit të luftës së Peloponezitet midis Athinës dhe Spartës, në një nga tekstet më klasike që sot mësohen në çdo kurs të lartë të marrdhënieve ndërkombëtare. A ma thotë dot kush cili nga*

shtetet e sotme që atëherë nuk ekzistonin fare i përkisnin Epidamni, Korinti, apo Korkyra e atëherëshme? E pamundur. Ne kemi kapërcyer vuajtje të përbashkëta, kemi përbashkët sfidat e njëjta, kemi trashëguar traditat tona, në sisteme shoqërore që janë ngritur dhe janë shembur, herë duke i bashkuar shtigjet tona të mbijetesës, herë duke i ndarë. Gjatë rrugëtimit tonë të përbashkët në qiellin e Perandorisë Osmane qendrat e sotme greke dhe shqiptare flisnin, sigurisht, në gjuhët e tyre, po flisnin edhe në gjuhë të tjera si turqishtja, hebraishtja, armenishtja dhe plot të tjera akoma dhe sigurisht edhe në gjuhët e kulturave hegjemonike perëndimore frëngjishtja apo gjermanishtja. Vetëm pas lindjes së Perandorisë nisi të lindë Europa e sotme, Europa e shteteve sovranë, ku pavarësia u bë e domosdoshme për të mbijetuar dhe ku heronjtë e popujve të ndryshëm morën pjesë në luftrat e njëri-tjetrit.

Koment: Një këngë popullore thotë “Ik, or djalë për kokën tënde, mos hidh kazmën vende-vende”, që do të thotë se “po të shoh që je i shfokusuar nga objektivi për të punuar tokën”. Edi Rama me fjalimin e tij kërkon t’u marrë mendjen dëgjuesve dhe emigrantëve duke u futur (kodra mbas bregut) qëllimisht në një diskutim të tillë që është krejt teorik dhe i tejkaluar edhe në atë fushë (pra nuk është ndonjë zbulim). Synimi i vërtetë që futet në këtë drejtim, është për t’i lodhur, për t’u krijuar bindjen gënjeshtarë “se këto punë janë të thella” dhe për t’i zgjidhur duhen edhe ca gërmime arkeologjike shkencore. Ndërkohë koha e mitingut kalon dhe “Ku ishe? Asgjëkund”.

Edi Rama: *Ku ka shembull më të mirë se heroina legjendare e pavarësisë greke Laskarina Bubulina, e lindur në një burg të Stambollit me prejardhje arvanitase, një luftëtare legjendare e lirisë së Greqisë, e para grua admirale në botë, në krye të një flote ushtarake detare. Tani, kush na ndalon ne që të mos jemi njëkohësisht krenarë, bashkë me grekët, për kontributin që i ka dhënë Greqisë ajo grua heroike me prejardhje nga një familje ku flitej shqip.*

KOMENT: Investimi në figurën e Laskarina Bubulinës është investim në asimilimin e emigrantëve dhe nga individë me vetëdije shqiptare, të kthehen, të konvertohen, si Laskarina Bubulina. Në një kuptim si Laskarina Bubulina ne kemi Piro Dhimën. Mundej t’ua jepte edhe Piro Dhimën si shembull. Pse nuk e dha? Sepse është më e qartë se çfarë nënteksti do të kuptohej, ndaj zgjodhi Laskarina Bubulinën.

Naim Frashëri dhe rilindasit e shekullit 19, që Edi Rama po në këtë fjalim i quan “fosile të shek 19” kanë tërhequr vëmendjen e shqiptarëve për të kundërtën e asaj që bën Edi Rama. Le të citojmë Naim Frashëri në po atë poezi që e citoi Edi Rama, por që citoi atë që i leverdisi.

Naim Frashëri, i pacituar nga Edi Rama, shkraun këtu në “Dëshira e vërtetë e Shqiptarëve”.

*“Të kesh Boçarin, Xhavellën, Miaulin, Bubulinën, E shumë heronj të tjerë, dhe ata të mos përpiqen për ty, Shqipëria ime, po për grekët e Greqinë!
O heronj të paharruar, u munduat kot së koti”*

Ndërkohë Edi Rama kërkon t’u mbush mendjen diasporës që Naim Frashëri ka mirë vetëm vargjet që dëshiron Edi Rama, ndërsa vargjet për Bubulinën, do t’i fshijë nga tekstet e shkollës dhe do t’u thotë emigrantëve shqiptarë, që mos e quani se u munduan kot së koti. Kur Naimi thotë “u munduat kot së koti” nuk e bën këtë nga një këndvështrim interesi grek, por këndvështrim shqiptar, që do të thotë se nga puna juaj në të vërtetë përfituan vetëm grekët dhe kjo shpesh ka përfunduar të jetë kundër interesit shqiptar.

E citojmë edhe një herë Edi Ramën “Kush na ndalon ne që të mos jemi njëkohësisht krenarë, bashkë me grekët, për kontributin që i ka dhënë Greqisë ajo grua heroike me prejardhje nga një familje ku flitej shqip”.

Në bazë të logjikës historike Naim Frashëri i ndalon emigrantët që të marrin komentet e Edi Ramës. Tani emigranti e di vetë me kë do të bëhet me komentet dhe interpretimin e Naim Frashërit, që i do në Shqipëri e të punojnë në Shqipëri apo me komentet Edi Ramës që i do të jenë krenarë për arritjet e Greqisë.

Edi Rama: Prandaj, ajo që, megjithëse, më kanë ikur të tëra fjetet e zeza, dhe këto të bardhat janë gjithnjë e më të rralla nuk e kuptoj dot, është, po a nuk është më e thjeshtë që ta çmojmë historinë e vjetër të popujve tanë si thesar përrallor i cili na përket të gjithëve duke e ekzaltuar me mendje të hapur në sytë e fëmijëve tanë europianë, jo duke e manipuluar dhe e përdorur me duart e rrudhosura të politikës ballkanike, të cilave kjo lagje e Europës u ka parë vetëm sherrin dhe shamatanë.

Koment: Sa pa qenë “plak”, argumenti e ishte ndryshe. Tani që po i afrohet pleqërisë, po shet “pleqërinë” si pjekuri. Kjo është arsyeja që u ka dhënë urdhër të gjithëve të lënë mjekëra, e të mos i lyejnë se duhet t’i kenë të bardha që të duken si mendimtarë, e jo ndryshe siç realisht janë. Pleqëria nuk e bënka t’i dojë emigrantët në Shqipëri, por t’i dorëzojë në Greqi. Pleqëria nuk ia shtonka urtësinë që të kërkojë falje për shpopullimin, por i shtonka “urtësinë” që të mendojë për raporte në përgjithësi pa qenë grek apo shqiptar. Albin Kurti është më i qartë në këtë gjë. Ai thotë “Unë nuk mund të luajë rolin e arbitrit. Unë jam shqiptar e do të luaj rolin e shqiptarit. Arbitrin ta bëjë dikush tjetër”.

Edi Rama: A nuk është më e ndershme karshi kombeve tona që ta ndajnë pa dyshim, pa tundim, atë që u përket popujve nga ajo që u përket shteteve, atë që u përket shteteve nga ajo që u përket partive dhe atë që u përket partive për zgjedhjet e ardhshme, nga ajo që u përket brezave të ardhshëm për cilësinë e paqes dhe sasinë e prosperitetit? A nuk është më e logjikshme

dhe ku e ku më produktive që Shqipëria dhe Greqia ta bashkëndajnë në partneritet të ngushtë strategjik si dy shtete fqinj dhe miq rrugën e demokracisë të prosperitetit dhe të vëllazërimit të vazhdueshëm të shqiptarëve dhe grekëve.

Koment: Futje qëllimisht në rrugicat qorre të diskutimit, aty ku argumenti merr tjetër kuptim, por ndërkohë shpenzon edhe kohën dhe çorodit. Këto biseda Edi Rama mund t’i bëjë me grekët, jo me shqiptarët. Duke i bërë me shqiptarët, ai po nënkupton se po i bën me grekët, pra po noterizon asimilimin e tyre. Mund të thuhet se ai i bën me diasporën, që këta të ndikojnë në Greqi. Kjo nuk ka kuptim, sepse shqiptarët nuk kanë asnjë forcë ndikimi politik në Greqi. Një nga drejtuesit e diasporës shqiptare në Selanik e ka thënë qartë “Nuk jemi aspak faktor politik në Greqi. Mund të jemi faktor në tregun e punës, por jo në politikë”. Ata nuk i lënë të bëjnë si duhet një shkollim shqip, jo më t’i lënë të bëjnë politikë greke. Atyre u ndërrojnë emrin dhe fenë, jo më t’i lënë të bëjnë hapa. Pra Edi Rama i fut ata në kauza donkishoteske, sepse ata nuk kanë asnjë zë në politikën greke.

Edi Rama shpik një këndvështrim “të përbashkët” me grekët, pra shpik “negociatorin e interesit të përbashkët”. Kjo i duhet për të instaluar çfarë është greke tek dëgjuesit shqiptarë. “Dakortësia fiktive” shqiptaro-greke është thjesht një presion mbi shqiptarët, të cilët vihen nën presionin e një “dakortësie shqiptaro – greke” që në fakt përcjell thjesht interesin grek dhe mbulohet si “shqiptaro – greke”.

Edi Rama: Në vend që të konsumojë kohë dhe energji të shekullit 21 për hesapet politike të disa partive këtej e disa partive andej, dhe për orekset e disa pseudopatriotëve fodullë dhe llafazanë. I kemi me shumicë edhe këtej edhe andej, tamam si fosile të gjalla të shekullit 19.

Koment: Qeveria e Partisë Socialiste e drejtuar nga Edi Rama ka shumë suksese në luftën ndaj “fosileve të shekullit 19”, me të cilën shkurt e qartë kuptohet Rilindja Kombëtare, rilindasit dhe ndjekësit e tyre, ose më shkurt patriotët shqiptarë, atdhetarët shqiptarë, nacionalistët shqiptarë. Nuk mund të gjendet sot për sot një shqiptar i vërtetë që të mos i referohet kësaj periudhe të ndritur si burim frymëzimi. Vijmë tani tek dëmi që i ka bërë Rilindjes Kombëtare: I hoqi emrin “Mësonjëtores së parë shqipe” në Korçë, 7 mars 1887. I hoqi statusin Muze Kombëtar i Arsimit. Kjo ndodhi me ligjin 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Hoqi me Vendim të Këshillit të Ministrave detyrën që Muzeu i Arsimit në Korçë të trashëgonte “Mësonjëtores e Parë Shqipe”. Sektit të tij i dha emrin “Rilindje” dhe këtë e bëri për të thënë që do të luftojë “fosilet e shekullit 19” që ishin instaluar në kujtesën kombëtare dhe në historiografinë tonë me termin lëvizja e Rilindjes Kombëtare. Këtë e bëri që populli të mësohej me termin “Rilindje” por të ç’mësohej nga fjala “kombëtare”. Nga ana tjetër termin më kyç të Rilindjes Kombëtare dhe të kulturës shqiptare, termin “Besa” ia dha për përpunim ideologjik Muzeut Hebraik në qendër të Tiranës. Për të çmontuar “fosilet e shekullit 19” bëri festë kombëtare jo 7 marsin 1887 që është i fiksuar në traditën e arsimit shqip, por 22 nëntorin 1908 që shihet si datë dytësore, edhe pse kombëtare. Por leverdia ishte se nga një

anë e ç'instalonte vëmendjen ndaj produkteve kombëtare të Rilindjes Kombëtare nga ana tjetër zhvendoste kufirin kohor duke e bërë më të cekët, më larg pavarësisë së Greqisë (rreth një shekull) dhe jashtë Shqipërisë, sepse 22 nëntori kujton Kongresin e Manastirit dhe Manastiri ndodhet jashtë Shqipërisë, ndaj duam s'duam do të merrremi vesh me maqedonasit që ta përkujtojmë.

Tani duhet që këtij sulmi t'i vihet kapaku duke ia thënë pikërisht atyre që nuk duhet, pikërisht atyre që i vlerësojnë më shumë Rilindasit e shekullit 19, sepse janë në pozicionin e tyre. Shumica e rilindasve ishin në diasporë dhe diaspora shqiptare e Greqisë do të duhej ta kuptojë më mirë mrekullinë që ka bërë diaspora e shekullit 19. Kryeministri po i frymëzon të harrojnë dedikimin kombëtar dhe po ua fyen këtë dedikim duke u vënë epitetin "fosile të shekullit 19".

Kryeministri dhe Partia Socialiste duhet të kenë kujdes se mos janë ata vetë që rreshtohen në "fosilet e një lloji tjetër" në "fosile të tradhëtarëve të shekullit 19", ndaj të cilëve Naim Frashëri thoshte:

*"Hiqni dorë, hiqni dorë,
Mblidhi ment e turpërohi,
Mos u bëj tradhëtorë,
Se pastaj do të pendohi."*

Edi Rama: Edhe sa shekuj do të rrojmë ne shqiptarët dhe grekët në këtë lagje të Europës moderne që ta mësojmë dhe ta pranojmë pa asnjë kompleks nacionalist, pa asnjë ndjenjë superioriteti ndaj njëri-tjetrit një të vërtetë të thjeshtë se jo vetëm shpirti i popujve nuk njih kufij, por edhe se kultura jonë e përbashkët mes thesare ballkanike është plazmuar, yy, shumë kohë përpara se gjuhët të bëheshin shpata dhe flamujt të ngriheshin shtiza për të përçarë dhe për të futur popujt në luftra, konflikte dhe ngatërresa. Pastaj si mundet si mund të vazhdojmë ne akoma me këto avaze të veshura me kostume të reja në vend që atë të vërtetën e thjeshtë ta bëjmë shtratin e përbashkët ku t'i lidhim përpjekjet por edhe rezistenca e popujve tanë në një botë ku ekzistenca e njerëzimit është e kërcënuar nga shkatërrimi jo i largët prej ngrohjes globale dhe deri edhe nga asgjësimi akoma më i shpejtë, mos e dhëntë Zoti, prej çmendurisë bërthamore dhe në vend që nën shembujt e popujve të tyre të kultivojnë dhe të vjelin frutet e lulishteve të përbashkëta ku qysh në agimin e kohës ka pasur terren pjellor për më të mirat e shkencës, dijes, artit, të Europës, elitat politike në historinë e fqinjësisë mes nesh si shtete, Greqia dyqind vjet, Shqipëria njëqind e pak vjet kanë gërmuar e gërmuar e gërmuar për aq shumë kohë, aq qorrazi, aq pa mëshirë llogoret e konflikteve, kanë ngritur aq shumë re të zeza të pluhurit keqdashës ndaj njëri-tjetrit dhe e kanë llanosur aq keq fqinjësinë dhe baltën e mërisë, sa kemi 30 e kusur vjet me një kapitull të ri historie e miqësie ku duket sikur mezi presim të djegim jorganin për një plesht. Mund të kishim mbjellë e të kishim korrur shumë më tepër fryte të suksesit të përbashkët si fqinj, si miq, si aleatë strategjikë duke përdorur pasuritë, mundësitë, energjitë tona, sigurime komplementare, të rritjes

së fuqisë dhe të mirëqënies së dy popujve tanë e duke u bërë shembuj rrezatues për krejt rajonin, në vend të hyjmë nga një cikël stinor në një tjetër, nga ngërçi në ngërç, kur pas vjeshtës, vjen dimri dhe pasi vjen pranvera që zgjat shumë pak, nuk vjen vera asnjëherë.

Koment: Kryeministri dhe Kryetari i Partisë Socialiste shpreson të heqë si këndvështrim këndvështrimin nacionalist, kur kjo është kaq e verifikueshme kudo në çdo popull. Shqiptarët nuk duan të heqin nacionalizmin grek, pra nuk dëshirojnë që ata të mos jenë nacionalistë, por të shmangin atë pjesë të nacionalizimit që vete kundër të vërtetës, kundër të drejtës, kundër praktikave më të mira që njerëzimi ka patur në çështjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Dëshira për nacionalizëm është e instaluar edhe në Kartën e të Drejtave të njeriut por aty atë e gjejmë në formën e ruatjes së identitetit kombëtar, të kujdesit për gjuhën, kulturën etj. dhe jo thjesht me termin "nacionalizëm".

Kryeministri vijon ta ngrejë zërin, e bën si i mërziur kur në fakt e di shumë mirë që ato që po thotë janë tërësisht në interes të grekëve, sepse grekët e dinë që ato nuk po i dëgjojnë grekët, por shqiptarët dhe nëse do të kenë ndikim pasojën do ta vuajnë shqiptarët dhe jo grekët. Grekët nuk presin t'u flasë Edi Rama si profet, e të lënë profetët e tyre grekë e të marrin fjalimet e Edi Ramës.

Naim Frashëri thotë:

*Oh, sa qenë të munduar
Ata që vuan për botë,
Turp të madh kanë rrëfyer,
Punuanë fare kot.*

Një nga këto punë të kota është ky fjalim nga një këndvështrim "arbitri" me një audiencë që pret tjetër gjë.

Edi Rama: "Ditën e tretë të mbërritjes në Athinë", - shkruan në kujtimet e tij ati themelues i shtetit shqiptar Ismail Qemali, - "u prita në audiencë nga Mbreti Jorgos I i cili më manifestoi miqësi të madhe dhe përkujdesje, një përkujdesje me të cilën ai më nderoi mua për tërë jetën. Mikëpritja që m'u afrua kudo, në atë kryeqytet që e dashuroja dhe admiroja qysh nga fëmijëria më preku aq thellë sa mua m'u duk se isha në atdheun tim, dhe kur shkoja nga festa në një festë, qëndrimi im në kryeqytetin e Greqisë nxori në sipërfaqe simpatitë e vjetra dhe politikanët me origjinë shqiptarë me llastuan me dhurata miqësie a thua se po i përgjigjeshin thirrjes së brendshme të kujtesës së hershme. Ata dukeshin si të mëdyshur para një vendimi nëse unë me bashkëpatriotët e mi do të bashkëpunonin me ta për të mirën e Greqisë apo nëse ata duhet të merrnin me vete edhe gurët e mëmëdheut të tyre të dytë për një lëvizje mbështetëse ripërtëritëse të vendit të tyre të origjinës. Unë isha aq krenar dhe i lumtur që vëreja se si ndjenja kombëtare ishte aq thellë e rrënjosur tek shqiptarët, pavarësisht shekujve të ndryshimit të kushteve politike-shoqërore. Pata një kënaqësi të madhe në ecejaket e mëngjeseve nën atë

qijell të mrekullueshëm të Atikës duke dëgjuar të flitej shqip nëpër rrugë e Pazar, por ndjenjën më të madh të kënaqësisë ma dha ajo që më tha ndihmësi i Mbretit i cili rridhte nga një prej familjeve heroike të Shqipërisë, kur po kalonim nga paradhoma tek audienca mbretërore. “Bej”, m’u drejtua ai, “mos e lësho veten para atyre kokënxehtëve. Bëj më të mirën për Shqipërinë e lirë që të gjithë ne të kthehemi dhe të bashkohemi atje”.

E për ta mbyllur këtë pjesë se kemi shumë kohë pa u parë dhe fjalimi im nuk është i shkurtër si zakonisht, Ati Themelues vazhdon “Megjithëse zhvillimet politike morën një drejtim tjetër nga ai i ndjenjave tona, unë jam i bindur që më shpejt sesa vonë dashuria e përbashkët e shqiptarëve dhe e grekëve për lirinë, do t’i udhëheqë ata drejt mirëkuptimit dhe krijimit të një kundërpe-she në gadishullin ballkanik për të mirën e të tërëve”.

Bravo, po merreni me mend, plaku i urtë i pavarësisë i ka botuar këto kujtime në vitin 1920 kur marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve tona ishin bërë shumë të vështira dhe, fatkeqësisht, vizioni gjenial i Ismail Qemalit atëherë ishte shumë tutje, ishte përtej horizonteve të kohërave që pasuan takimin e tij me Mbretin e Greqisë.

Koment: Përputhja e përkohshme e interesave shqiptaro - greke është një fakt, por shtrirja “e të përkohshmes” në të përhershme nuk është fakt, por mund të jetë një dëshirë, dhe shpesh një utopi. Historianët shqiptarë kanë vërejtje për rreshtimet progresive të Ismail Qemalit. Nuk duam të themi se e kanë mirë apo jo, por e vërtetë është që nuk ka një dakortësi të gjerë në këtë pikë.

Edi Rama: Lufta e Dytë Botërore, mbyllja hermetike e Shqipërisë në rrethin e nëntë të ferrit komunist e ndau Europën medyshe dhe e shtyu deri në fundin e shekullit 20 mundësinë që të rikthehej ky vizion i atit tonë themelues në tryezën e marrëdhënive të rivendosura tërësisht mes dy shteteve pas shembjes së komunizmit. Po iku shekulli 20. Po vjen mesi i dekadës së dekadës së tretë të 21 dhe, në vend që Shqipëria dhe Greqia, të ishin sot një kundërpeshë triumfi dhe fqinjësisë së kthyer në një aset strategjik gjeopolitik në panoramën e Ballkanit dhe një shembull tërheqës për të gjithë fqinjët e tjerë që ta ndiqnin për paqe që prodhon mirëqënie, siguri, ardhmëri në tryezën e marrëdhënive tona ndërshtetërore rri akoma në fuqi Ligji i Luftës së Greqisë dhe Shqipërisë. Ai ligj i 10 nëntorit 1940 përcakton ç’bëhet me pronat e me shtetasit e vendeve në gjendje lufte, dhe po atë ditë, me dekret mbretëror ligjërohet gjendja e luftës me Italinë dhe me Shqipërinë. Në vitin 1947 Greqia ratifikon traktatin e paqes me Italinë dhe gjendja e luftës mbaron, ndërsa me Shqipërinë dekreti i gjendjes së luftës dhe për rrjedhojë pasojat e ligjit të luftës mbeten në fuqi sot e gjithë ditën, megjithëse në vitin 1998 të dyja shtetet kanë miratuar Traktatin e Miqësisë. Po si ka mundësi në mes dy shtetesh që ka nënshkruar një Traktat të ri Miqësie që janë bashkë në NATO prej 15 vjetësh të mos jetë shfuqizuar akoma gjendja e luftës bashkë me pasojat e një ligji

lufte të 84 viteve më parë. Në këto vite, unë dhe qeveria jonë jemi përpjekur sa kemi mundur që ky absurditet të largohet nga tryeza e marrëdhënive tona, ashtu sikundër jemi përpjekur që t’i adresojmë sa më drejt me dialog, me mirëkuptim, të gjitha çështjet e mbetura mes dy shteteve tona sepse unë kam bindjen e palëkundur që nëse ka vullnet të mirë dhe vendosmëri reciproke të gjitha mosmarrëveshjet e trashëguara mund të zgjidhen pa prituri që të kalojnë edhe 84 vjet të tjera.

Koment: Pranimi i ekzistencës së Ligjit të Luftës është një hap kaq i vonuar nga politika shqiptare por edhe e vetë Kryeministrit Rama që në këto 84 vite ka 11 vjet të vetat. Fakti që thotë “unë dhe qeveria jonë jemi përpjekur sa kemi mundur që ky absurditet të largohet nga tryeza e marrëdhënive tona”, provon që ai nuk e ka bërë pjesë të diskutimeve Ligjin e Luftës aty ku duhet në tryezat me grekët, nuk e bën në Parlamentin e Shqipërisë që po të dojë ia jep zgjidhjen me anë të presionit ndaj Greqisë, nuk e bën në Partinë Socialiste, por bën sikur e bën problem duke e përmendur aty ku thjesht është propagandë.

Edi Rama: E vërteta është, miqtë e mi, se tek kryeministri aktual i Greqisë unë kam gjetur bashkëbiseduesin më të hapur të këtyre viteve, ndërkohë, më është e pamundur mos ua them se qasjet dhe opinionet e sivëllëzerve tanë të majtë të opozitës greke unë e kam patur shumë të vështirë t’i kuptoj si luftë të brendshme politike. Po s’është as puna ime t’u jap atyre mend, edhe pse, në fakt, jemi në një familje politike europiane edhe mend mund t’i japim njëri-tjetrit, as e drejta ime që të ndërhyrë në punët e tyre, aq më tepër kur edhe në Shqipëri ne e kemi një opozitë që bën ekzakt të njëjtën gjë, sa herë merret me punët e jashtme të Shqipërisë burive të nacionalizmit elektoral, por, thjesht do t’u thosha sot shumë miqësisht meqë jam edhe këtu në Athinë edhe me siguri dëgjojnë se kur kanë ndërmend të përmendin Shqipërinë dhe të komentojnë qëndrimet e qeverisë socialiste të Shqipërisë me siguri do t’i ndihmonte në formimin e opinionit të tyre sa më korrekt edhe një komunikim i drejtpërdrejtë me sivëllëzërit e tyre në Tiranë. Nga ana tjetër, është po kaq e vërtetë që megjithëse bashkëbiseduesi im i sotëm në pallatin ... është më i hapuri dhe më i interesuari për ta mbyllur kapitullin e çështjeve të mbartura puna për zgjidhjen e tyre ka ecur ngadalë dhe ka ngecur herë pas here. Megjithatë unë kam besim se kjo nuk është një fjalë e bukur diplomatike. Realisht kam besim se më e mira mes Greqisë dhe Shqipërisë është e gjitha përpara dhe këtë besim e kam të armatosur me gatishmërinë që ne t’i zgjidhim të gjitha çështjet mes nesh si europianë largpamës të shekullit të ri. Jo të vazhdojmë t’i zvarrisim si ballkanas sylesh të shekullit tjetër për t’i kthyer pastaj në mollë sherri sa herë hapen tezgat e pazareve elektorale. Ndërkohë më vjen vërtetë keq për faktin se këto ngricat ciklike e kanë penguar që të duket edhe progresi që gjithësesi kemi bërë në disa drejtime me rëndësi. Më në fund, me qeverinë aktuale se me atë më parë se as nuk bëhej fjalë, kemi arritur të çelim negociatat në nivel ekspertësh për marrëveshjen e pensioneve me Greqinë. Është një marrëveshje për të cilën

deri dje nuk shikonim asnjë dritë në fund të tunelit, ndërkohë që besojmë pas realizimit të marrëveshjes së pensioneve me Italinë kemi edhe një referencë shumë pozitive sepse faktikisht ajo me Italinë dhe kjo me Greqinë janë edhe dy marrëveshjet më komplekse për shkak dhe të peshës që ka faktori shqiptar në të dyja shtetet. Po ashtu dhe besojmë që kjo ju intereson shumë, edhe dialogun dypalësh, në nivel teknik për problematikën e lejeve të qëndrimit dhe për procedurën e marrjes së shtetësisë me natyralizim dhe ka goxha progres dhe unë jam besimplotë që shumë shpejt ju do të merrni lajme shumë të mira. Një tjetër synim i përbashkët strategjik dhe i dakortësuar mes dy qeverive tona është bashkërendimi i nevojave dhe i oportuniteteve ekonomike të dy shteteve tona për aksesin dhe pozitat në tregun e integruar europian të energjisë. Sot punohet për projektin e linjës së dytë të transmetimit 400 KW Fier Araksos, një projekt me rëndësi strategjike për të dyja shtetet, i cili jo vetëm konsolidon rrjetin transmetues po fuqizon ndërlidhjen fizike të Shqipërisë dhe Greqisë për përmbushjen e kushteve të integritetit në tregun europian të energjisë duke krijuar siguri që çmimet do të jenë më konkurruese por edhe duke zgjeruar kapacitetet eksportuese të energjisë së prodhura nga burimet e rinovueshme nga të dyja vendet. Një tjetër faqe e bukur bashkëpunimi dhe afrimi e kemi hapur me propozimin tonë dhe dakortësinë me thënë të drejtën të menjëhershme të qeverisë greke për ta integruar duke bërë një integrim ndërkufitar Parkun Kombëtar të Vjosës, i cili vitet e ardhshme gjithnjë e më i fuqishëm i industrisë sonë të re të turizmit, por duke u rikthyer në një park europian të integruar ku s'ka kufi. Po triumfon natyra që na bashkon qysh se kemi ardhur në këtë botë. Do të jetë një shembull magnetik qoftë për çfarë mund të bëjnë së bashku Shqipëria dhe Greqia me njëra-tjetrën, për njëra-tjetrën dhe për Europën tonë, qoftë për turistët dhe vizitorët nga e gjithë bota.

Koment: Ne nuk kemi asnjë interes të komentojmë se kujt i bën mirë me këto deklarata njërit apo tjetrit krahas grek. E qartë është se “arbitër” ndërmjet pozitës dhe opozitës greke nuk ndenji, por mori, sipas zakonit anën e pozitës pra të qeverisë, që do të thotë se mund të jetë kjo një nga arsyet e lejimit “bujar” për të organizuar takimin, pa komente të mëpasme. Nëse nga ana ligjore mitingu mund të mos pengohet, nga ana e përpunimit propagandistik, kjo nuk ishte në dorën e “ligjit” por të medias që kontrollohet nga politika. Qartësisht media që bën sikur “ankohet” nuk ka qenë kundër takimit që do të thotë se mesazhet e dhëna brenda kanë qenë në interesin më të thellë të grekëve dhe mesazhi kryesor është që “ju do të rrini këtu dhe jeni mirë të rrini këtu, por përshtatuni dhe flijeni mendjen se ne nuk investojmë në arsimin shqip si shtet”, që ka vlerën e frymëzimit të fëmijëve për të jetuar në Shqipëri.

Edi Rama: Shqipëria 2030 do të ketë fituar pavarësinë e vet të plotë energjitike dhe do të jetë eksportuese neto e energjisë. Kjo do të thotë se asnjë qindarkë më nga taksat e shqiptarëve nuk do të shpenzohet për blerje energji jashtë, por përkundrazi, më

shumë para do të hyjnë në buxhetin e Shqipërisë edhe nga shitja e energjisë së prodhuar në vend.

Koment: Vini re tani se si nga viti 2024 kur bëhet mitingu eksportohet “tinëz” në vitin 2030, me mendimin “tani nuk jemi gati”.

Edi Rama: Ne po bëhemi gati këto kohë një program të veçantë për të gjithë emigrantët shqiptarë që duan të investojnë kursimet e tyre në fshatrat dhe zonat malore të Shqipërisë për t'i kthyer shtëpitë dhe trojet atje në hallka të zinxhirit të industrisë sonë të re të turizmit. Shembujt i kemi nga Thethi e Valbona, në Tepelenë e në Përmet, ku me kursimet e punës në emigracion dhe falë dijes, eksperiencës, kulturës së punës së fitur larg shtëpisë ata që janë kthyer nga mërgimi kanë hapur agroturizëm e bujtina që janë plot me turistë, të cilët u sjellin në bilancin e fundvitetit shumë e shumë të ardhura sesa paga e emigracionit. Disa janë kthyer për fare, disa të tjerë mes shtetit ku janë dhe vendlindjes, por të gjithë e shohin se llogaria del për bukuri dhe investimi në vendlindje shpërblehet më së miri.

Koment: Qartësisht abuzive. Ç'lidhje ka “bërja gati” për ndonjë projekt turizmi, kur emigranti e ka shtëpinë këtu, ose mund të blejë një shtëpi që dikush tjetër e shtet dhe të bëjë çfarë pune të dojë në Shqipëri? Pse duhet që vëmendja e diasporës shqiptare të fokusohet vetëm në një projekt që mbas 34 vjetësh ende nuk qenka gati por ai projekti i madh do të bëjë çudira? Çfarë i duhet projekti turistik dikujt që nuk ka nevojë për të, por do të punojë si ekonomist, si inxhinier, si pastičier në Tiranë, në Shkodër, në Vlorë etj. Kjo bëhet qëllimisht e mangët, sepse kryeministri nuk e do kthimin e tyre, dhe nuk do as të flasë as të marrë mendim se si duhet të jetë kthimi. Kjo është arsyeja që ai vazhdimisht i shmang ballafaqimet me organizatat e vërteta të diasporës shqiptare.

Edi Rama: Shqipëria e 2030-ës do të jetë një vend zgjedhje të lirë, por më të detyruar nga halli apo nga pamundësia për të gjithë ata shqiptarë që do të mendojnë ta kërkojnë fatin e tyre gjatë si njerëz të lirë të kësaj bote, ku kufijtë e vendlindjes dhe shteti ku kalon fëmijëria deri në moshën për të marrë vendime nuk mund të jenë pengesë për askënd që spostohet drejt horizontesh e realitetesh të reja. Përtej mjegullës së dizinformimit që përcjell lajme të fabrikuara ditë natë nga mendjet më të liga shqiptare, mendjet e liga që i kemi nga mbrapa qysh nga viti 1912 që ndryshojnë emrin e njeriut, ndryshojnë formën e njeriut por nuk ndryshojnë në përmbajtjen e tyre dhe flasin të njëjtat gjëra përmes gjuhës së njerëzve të ndryshëm si për shembull rënia e popullsisë së Shqipërisë në 1.5 milionë, përtej tymit të zi të luftës politike dhe fenomenit të emigracionit që në kohë e cikle të ndryshme i ka prekur të gjitha vendet e kësaj bote e jo më pastaj Shqipërinë që doli pas gjysmë shekulli burg, nga një burg ku çelësat ishin hedhur në det, përtej të gjitha projekteve, reformave, punëve, mundësive të reja, dhe përtej të gjitha krahinave, besimeve, bindjeve, dhe politike është sot e gjitha e arritshme për t'u zotëruar si vullnet i të gjithë shqiptarëve kudo ndodhen maja e Shqipërisë 2030.

Koment: Shikoni “strukturën sintaksore përbindëshe” për të shmanhur një gjë të thjeshtë. Kryeministri nuk dëshiron të thotë “Ejani në Shqipëri!” ndaj shpik një fjali që nuk menaxhohet dot në atë që kërkon të thotë dhe bën sikur e thotë që nuk e thotë atë që do të thotë etj. etj. (po ndjekim stilin e tij).

Kur unë bëra intervistën në A2CNN edhe gazetari bëri gabimin dhe tha atë që nuk e tha kryeministri. Citoj gazetarin “Zoti Rama u tha: “kthehuni në Shqipëri, të investoni atë që keni mbledhur këtu, sepse taksat janë gjithashtu më të lira”. Kryeministri nuk ka thënë në asnjë rresht “Kthehuni në atdhe”, mirëpo kryeministri dhe ekipi i tij i shkrimit të fjalimeve bëri ato makinacione të llogaritura në mënyrë “shkencore” me gjuhën e folur në atë mënyrë që të linte përshtypjen sikur e tha. Lexuesi këtu e ka fjalimin të plotë 100% dhe ta gjej se ku e ka thënë. Nuk e ka thënë. Po a nuk është diabolike që teknologjia më e lartë të shfrytëzohet për të lënë një përshtypje të gënjeshtërt që gabon edhe një media jo më dëgjuesin e thjeshtë. Naim Frashëri thotë “O njerëzit e vërtetë, ju qofsha falë për jetë!”. Është detyrë e kryeministrit të jetë i vërtetë kur flet aq më tepër në një takim të tillë të rrallë për nga forma.

Edi Rama: Në këtë historinë e stërvjetër të civilizimit evropian ku pjelloria e mendjeve të ndritura, shoqërimi me bestytini në perëndi, gjysmëperëndi, apo njerëz të thjeshtë që ëndërronin të shndërroheshin në perëndi dhe ku historia e këtij pellgu të përbashkët lindi në këtë qytet të vetmin sistem qeverisje që ia kthen lirinë individit duke respektuar vullnetin e shumicës pagëzuar nga grekët e lashtë me emrin e bekuar demokraci, historia e re e shqiptarëve të Greqisë i një afirmimi shembullor të vlerës së përjetshme të lirisë së individit dhe të drejtës së qytetarisë dhe nuk rashë në përsëritje por desha të shtoj se demokracia është një sistem sa sfidues aq edhe kuptimplotë, sa edhe vetë termi që i gjen rrënjët në fjalën “kratos” (forcë) e cila nuk e pse mua më asociohet gjithmonë me fjalën hyjnore shqipe “krijoj” forcën krijuese të demokracisë, si fuqi jo shkatërruese, si fuqi që sjell mundësi gjithnjë të barabarta për të gjithë jo thellim të pabarëzisë dhe të diskriminimeve.

Koment: Për çfarë shërben kjo fjali kaq e gjatë përveç për ta çorientuar dëgjuesin aq sa të mos e ketë mendjen në cilësinë e fjalisë që vjen më pas.

Edi Rama: Shqipëria 2030 duhet t’ia marrë më të mirën e mundshme përmes fuqisë së të gjithë shqiptarëve që flamuri kuqezi i Skënderbeut dhe i Ismail Qemalit të ngrihet në krah, të flamujve të shteteve anëtare të BE atje në qendrën e Europës demokratike.

Koment: Shqiptarët duan të dinë 2024, kryeministri i eksporton pas 6 vjetësh. Kjo është e turpshme. Pra edhe pse vizita e një kryeministri shqiptar bëhet pas 34 vjetësh emigracion, kryeministri ka gojë e u thotë që duhet të bëhen 40 vjet, para se ata të mendojnë të kthehen në një atdhe si Shqipëria. Kjo do të thotë që ai që është larguar 20--30

vjeç në 90, të jetë 60-70 vjeç në 2030, ndërkohë që fëmijët e tij kanë lindur të gjithë në Greqi dhe para se të kujtohet Shqipëria Greqia ua ka mbushur trutë me gjuhë greke, kulturë greke, përvojë greke, mësues grek, komunitet grek, media greke, libra grek dhe kryeministri tallet e u thotë në 2024 se duhet të ëndërroni ta kapni 2030.

Edi Rama: Sot ju e shihni Shqipërinë kur vini, dëgjoni për Shqipërinë kur ju flasin, lexoni për Shqipërinë kur u nxjerrin nga kanalet dhe portalet lloj-lloj gjërash, por sot Shqipëria ka nisur t’ju ngajë ju, ka nisur të ngajë përditë e më shumë e rrugëve të stërmundimshme të emigracionit që falë përpjekjeve titani-ke të viteve nga gjysmë të vdekur e lekosur dhe të damkosur të shtigjeve malore dhe brigjeve detare rilindën, rilindën dhe u bënë zotër të fatit të tyre në Europë. Albania, Alvania, sot ka rilindur në sytë e botës dhe nuk asociohet më me vendin e zymtë të të gjitha këqiave por me një destinacion për t’u zbuluar, për t’u prekur, me një vend njerëzish mikëpritës dhe ambiciozë që po ia ndryshojnë faqen Shqipërisë me një shtet që në dyert dhe sallonet e Europës dhe të botës nuk shihet më as me dyshime, as me keqardhje por me respekt dhe me vlerësim. Sot ju nuk e ulni më kokën kur thoni jam nga Shqipëria dhe siç atdheu juaj ka qenë gjithnjë kryelartë për ju, ju sot jeni në drejtën e zotit të jeni kryelartë për Shqipërinë.

Koment: Me këto komente ai thjesht i torturon emigrantët, sepse ata kanë mbetur pa atdhe. Edhe pse kaloi nga 2030 (nesër) tek “sot”, dhe e zbukuroi Shqipërinë (që realisht nuk është ashtu), përsëri nuk u thotë “ejani sot”, por u le (edhe atë me nënkuptim) ndoshta vini nga viti 2030”. Saktësisht ka thënë (edhe një herë e citojmë): “Shqipëria 2030 duhet t’ia marrë më të mirën e mundshme përmes fuqisë së të gjithë shqiptarëve që flamuri kuqezi i Skënderbeut dhe i Ismail Qemalit të ngrihet në krah, të flamujve të shteteve anëtare të BE atje në qendrën e Europës demokratike.” Ku është “EJANI TANI!” në këtë që ka thënë? Thjesht një stërhollim i gjuhës, një pingpong i qëllimtë fjalësh që të lërë të kuptohet “më duket se e ka fjalën për atë që unë kujtoj” kur në fakt ka thënë diçka tjetër. Sikur të ishte noter apo avokat me këtë gjuhë do të kishte marrë gjysmën e Shqipërisë pa u vënë re. Në fakt ata që janë juristë e shohin përditë në aktet ligjore që nxirren përdorimin e gjuhës evazive edhe në ligje, jo më në një fjalim propagandistik.

Edi Rama: Shqipëria e deridjeshme nuk u mbante dot. **Shqipëria e sotme po bëhet gati** edhe për këdo nga ju që dëshiron apo mund të dëshirojë të kthehet, por Shqipëria 2030 do të jetë vendi ku kush do të rikthehet do të ketë një Shqipëri të vetën, si veten, për veten një shtet evropian në gjirin e Europës, një shtet demokratik, ku më së fundi, pas shekujve të tërë ligji i barabartë për të gjithë dhe askush mbi ligjin.

Koment: I vetëdijshëm që kjo do të ishte mungesë e jashtëzakonshme e fjalimit, vini re se çfarë ka thënë “Shqipëria e sotme po bëhet gati”, por kjo “gatishmëri” do të jetë thjesht “gatishmëri” deri në vitin 2030. Atëherë duhet të kthehen dhe atëherë ua ka lënë me “kushdo që do të kthehet”. E rëndësishme nuk është çfarë do emigranti, por çfarë do

shteti shqiptar nga emigranti. Kryeministri nuk përgjigjet për vendimet individuale të emigrantëve, por përpigjet për vendimet e shtetit dhe në këtë fjalim të tijin kryeministri nuk ka bërë asnjë ftesë “Ejani kthehuni tani!”. Nëse individit i lejohet të thotë “Po si të kthehemi kur të tjerët po largohen?”, shtetit i takon të thotë “Edhe pse po largohen, ata do të pendohen sepse vërtetë Shqipëria do të bëhet shpjet e ne do ta bëjmë kështu e ashtu por ne nuk mundemi ta bëjmë pa njerëz dhe pa shqiptarë. Nëse e kemi gabim po ikim, po gjejmë njerëz të tjerë të aftë ta drejtojnë Shqipërinë”. Po kush e lë kryeministrin të flasë kështu? Nuk e lë as interesi, as tiparet e personalitetit, as përvoja, as fakti, dhe nuk e lënë as të tjerët për të cilët punon natë e ditë e që qartësisht nuk përfaqësojnë një interes shqiptar.

Edi Rama: Kohët kur të tjerët vendosnin se deri ku mund ta hidhnin hapin shqiptarët kanë vdekur. Koha e shqiptarëve dhe Shqipëri në Europë ka ardhur.

Koment: I çliruar shpejt e shpejt, pa qëndruar aspak nga detyrimi (makth) që t’u fliste emigrantëve shqiptarë për kthimin e tyre në atdhe, doli menjëherë në terrenin e gjerë të fjalëve të kota që përpunojnë një mentalitet “krenar” për të cilën Sami Frashëri thotë “Krenaria ka shkaktuar prishjen e shumë shteteve dhe kombeve”. Nëse Sami Frashëri nuk klasifikon ndërmjet “krenarisë boshe” apo “të përligjur” mund të merret me mend sesa dëmton “krenaria boshe” në raport me “krenarinë e përligjur”. Në fakt, shpopullimi është tipar i kësaj epoke dhe tipizim i “klasës politike shqiptare”.

Edi Rama: Shumë të dashur miq, motra dhe vëllezër. Rrofshi që më nderuat kaq shumë. Mbarësia qoftë emri i çdo dite të re për ju, të afërmit, të gjithë ata që u do zemra. Jeni shembuj, jeni energji, jeni forcë për mua. Unë nuk kam si ta hap zemrën dhe trurin tim që ju të hyni e të shikoni vetë çfarë ka brenda, po unë nuk iki dot sot pa ju thënë edhe dy fjalë: Gabime unë mund të kem bërë plot në këto dhjetë vjetë. Ju kërkoj ndjesë për çdo gabim që ju mendoni se kam bërë, por kurrë në asnjë rast, nuk i kam tradhëtuar ata që ma kanë besuar qoftë edhe një herë me votën e tyre këtë nder të jashtëzakonshëm. Nuk ka nder më të madh që mund t’i bëhet një njeri në jetë sesa të udhëheqë vendin e tij, prandaj nuk ka forcë materiale në këtë botë, fuqi politike, ekonomike, financiare, individ apo shtet që, mos o zot, të më joshë a më detyron dot mua të përkulem për të përfituar për veten pas shpinës suaj për të cënuar interesat publike dhe private të shqiptarëve që unë nuk i njoh, por e di shumë mirë që ata më njohin mua, apo për të përkulur majat e paprekshme të interesave kombëtare të Shqipërisë.

Koment: 1. Edi Rama ka përvetësuar demokracinë, që mbështetet në forumet kolegjiale. Ai duhej të shkonte në diasporë bashkë me përfaqësues të parlamentit ose të inteligjencës shqiptare, të universiteteve, të shkollave shqipe. Nuk e bëri këtë dhe tani bën sikur falet para popullit sikur të ishte “monark” që detyrën e gëzon me kushtetutë dhe nuk ka çfarë të bëjë e do të bëjë edhe ndonjë rrëfim.

2. Nuk heq dorë nga betimet që janë “finoke” pra me bisht “evaziv” dhe diabolik”. Marrim edhe një herë çfarë tha më sipër: “kurrë në asnjë rast, nuk i kam tradhëtuar ata që ma kanë besuar qoftë edhe një herë me votën e tyre këtë nder të jashtëzakonshëm”. Kjo është e turpshme! Detyrimet e një kryeministri nuk janë ndaj atyre që kanë dhënë votën, se ai nuk menaxhon interesin e tyre por menaxhon interesin kombëtar që nuk është shkruar tek ata që ia kanë dhënë votën kryeministrit, por është shkruar në kushtetutë, në ligje, në historinë kombëtare. Detyrimin e ka ndaj ligjit dhe jo ndaj atyre që kanë dhënë votën. Për nga mënyra se si jepet e si merret vota në Shqipëri, referenca ndaj atyre që kanë dhënë votën është kategorizimi më i ulët i detyrimit të një politikani. Me fjalë të tjera, ai po thotë “që nuk njoh detyrime të tjera”. Atëherë për çfarë shkon tek emigrantët sepse dihet që ata nuk votojnë e nuk të kanë votuar, ngaqë kanë qenë në Greqi. I bie (hipotezë) që nëse akuzohet për ndonjë shpërdorim fondesh ne ta kujtojmë që nuk janë fondet e atyre që e kanë votuar, por pjesën që kanë të tjerët. Ja se si ky lloj betimi nuk duhej bërë. Njeriu, kur betohet, aq më tepër në sy të opinionit publik, betohet në mënyrë absolute dhe jo në mënyrë pjesore, relative. O je o s’je. Megjithëse Edi Ramën askush nuk e detyron të betohet, ai zgjedh të betohet dhe kur bën betimin e bën pjesërisht. Detyrimet janë ndaj të vërtetës dhe jo ndaj personave.

Një interes i lartë shqiptar dhe i provuar që është shkelur me të dyja këmbët është mungesa e investimit në arsimin shqip të diasporës. Kryeministri i lejon vetes të bëjë shpenzime kolosale për qëllime të votës, duke tejkaluar disafish vetëm me një miting shpenzimet që duhej t’i merrnin dhjetëra mijë nxënës e të rinj shqiptarë në Greqi. Pse garanton kot? (Për mitingun mund të jenë shpenzuar të paktën 200 apo 300 000 euro (mijëra persona, shumë prej tyre administratë nga Shqipëria, dieta, transport, hotele, bodigardë, makina, flamuj, media, gazetarë etj). Librat që ka shpërndarë nëpër shkolla (që në fakt nuk kishte pse të ndaheshin, kur mund të shtypeshin nga vetë shkollat dhe kursehej) janë në një vit rreth 6000 libra për të gjithë botën. Ja ta marrim që libri bën 10 euro, gjithsej janë 60 000 euro të shpenzuara për të gjithë botën, nuk janë paguar mësuesit. Kur në fakt vetëm në Greqi shpenzimet vetëm për librat do të duhej të ishin 1 milionë dollarë, nëse do të kapej çdo fëmijë e i ri shqiptarë. Tani për çfarë duhen garancitë që jep për ndershmëri? Nuk u kërkuan nga audienca për betime. Kjo do të thotë që ai do të vijojë në këtë rrugë, me mendimin se jam betuar.

Edi Rama: Vangjush, kjo ishte vizita ime më e bukur në Athinë dhe unë nuk besoj se do të kem një më të bukur sesa kjo.

Koment: Faturën e këtij udhëtimi të bukur e paguan populli. Mbase e ka paguar edhe Greqia dhe duhet t’i jetë mirënjohese.

Edi Rama: Përpara se tani të largohem, dhe në pamundësi që ta takoj, dëshiroj që edhe në emrin tuaj t'i lë një pusullë mi-kut tim të zgjedhur nga populli i këtij vendi për të udhëhequr Greqinë kryeministrit Micotaqis:

*I dashur Qirjakos,
Në vitin 1886 Poeti ynë Kombëtar Naim Frashëri shkruajti në greqisht vjershën e tij “Dëshira e vërtetë e shqiptarëve”.*

*“Duam me të gjithë fqinjët sllavë e grekë të jetojmë në harmo-ni në vëllazërim me rend e paqe të jetojmë. Le të mos bëhemi armiq e të mos zihemi. Mjaftojnë vuajtjet e shumta dhe tiranitë që kemi kaluar. Është koha e mirëqënies. Është koha e lirisë.”
Shumë të fala nga unë dhe shqiptarët në Greqi.*

Koment: Në ka njeriu më të dëmtuar nga Qeveria Socialiste dhe sekt i Rilindjes Kombëtare është Naim Frashëri. Nuk është dëmtuar vetëm filozofia dhe trashëgimia e Rilindjes Kombëtare, dhe trashëgimia e “Mësonjëtores së parë shqipe” të Korçës ku Naimi dhe Samiu janë autorë, por është dëmtuar edhe individualisht në emër, Naimi dhe Familja Frashëri dhe është dëmtuar pikërisht nga stafi i ngushtë i Edi Ramës, pikërisht ai që mund të ketë përgatitur edhe këtë vizitë të tij në Greqi e që merret me çështjet e historisë. Një këshilltar i Edi Ramës kur u pyet nga Blendi Fevziu për shprehjen e Naimit “O diell që lind nga

perëndon”, iu përgjigj se Naimi ka shkruar greqisht, pra shfrytëzoi ras-tin më të vogël për të lidhur kujtimin e Naimit me faktin që ka shkruar në greqisht “Dëshira e vërtetë e shqiptarëve” që dihet pse e ka bërë, sepse ka ditur greqisht dhe e ka shfrytëzuar si mënyrën më të mirë që të gjithë grekët të dinë mirë se çfarë duan shqiptarët.

Natyrisht që kur bëhet fjalë për të dhënë mesazhe paqe, mirëkuptimi ndërmjet popujve nuk do të zgjidhen analizat problematike, por do të zgjidhen ato që janë pozitive dhe këtu nuk mund të kemi vërejtje pse kryeministri ka zgjedhur këto.

Edi Rama: Rroftë Shqipëria. Rroftë Europa demokratike. Zoti i bekoftë shqiptarët dhe vëllazërit e tyre grekë dhe hap një faqe të re vëllazërie, rendi european dhe paqe me prosperitet mes Shqipërisë dhe Greqisë.

Koment: Mirë do të ishte të thoshte “Ju presim të ktheheni përgjith-monë në Shqipërinë tuaj” por nuk e thotë sepse e di shumë mirë sa larg duhet t’i rrijë këtij objektiv.

Artur Shkurti

Tiranë, më 21 maj 2024



DËSHIRË E VËRTETË E SHQIPTARËVE

Marrë nga Naim Frashëri, vëllimi 2, botues Faik Konica, Prishtinë, 2000, faqe 89-102. Shënim sqarues i botuesit: Këtë poemë Naim Frashëri e shkroi greqisht dhe së pari u botua në Bukuresht më 1886 me titull “O alithis pothos ton Skipetaron”. U përkthye më parë nga Kriso Floqi, përkthim i botuar në 1904 në Sofje. Botimi i dytë në 1912 dhe botuesi “Faik Konica” ka zgjedhur përkthimin e Pano Çuka, botuar në “Vepra të zgjedhura”, vëllimi I, Tiranë.

O ju bij të mëmëdheut, ju o patriotë trima,
Luftëtarë të dëgjuar edhe po kaqë të urtë,
Të bashkuar si vëllezër neve jemi kurdoherë,
Krahë të vendit të shtrenjtë edhe besnikë ndaj kombit.

Dhe kështu lipset të jemi, si përherë të bashkuar.
Ca më shum’ sot që tirani mezi mbahetë në këmbë,
Ne duhet edhe më fort të lidhemi që të gjithë,
Për qëllimin ton’ të shenjtë, në emërin e lirisë.

Ju, stërnipër të të Madhit Aleksandër e të Pirros,
Të dëgjuar, të lavdishëm, ju, o bij të Skënderbeut,
T’atij burri të vërtetë, që në botë shok s’ka pasur,
Trima, shpresa dhe guximi kurdoherë të na prijnë
Dhe të gjithë me një mendje të bëjmë detyrën tonë.

Ne pellazgë kemi lerë para se të lindte hëna,
Kur Adami nuk ka qenë veçse ujë edhe pluhur,
Dhe të parët tanë s’ishin vetëm baballarë popujsh,
Porse ishin baballarë dhe të vetë perëndive.

Motit, gjuha jon’ e dliërë, gjuha jonë e pavdekshme,
E kulluara, e kthjellta, mahniti dhe perënditë.
Askush s’e mohon në botë famën e të parve tanë
Dhe punërat e shkëlqyera ua dëshmon historia.

Dikur në Azin’ e largët si shqiponja fluturuan
Edhe fronin e Dariut e përmbysën ata trima.
Duke thyer në betejat ç’qenë përsanë barbarë,
Dhe qytetërimin mbarë e shpëtuan nga rreziku.

Tjetër herë, si luanër, ata iu vërsulën Romës
Dhe romakëve mizorë më t’u kallën lemerinë.

Kush qe ai burr’ i huaj, kush qe ai maqedonas,
Që dikur grekët në luftë fund e krye i dërrmonte?

Dhe kush qe njeriu i shquar, që më kot grekët e thyer
U munduan me sofizma porsi grek ta paraqitnin?

Kur të huajt pa të drejtë rojën kishin masakruar,
Cilët qenë ata që Thivën e rrënuan po shtëpinë
e Pindarit nuk e prekën, sepse përnderonin muzat?
Ata s’qenë aspak grekër as dhe skitë, jo, nuk qenë;
Maqedonët tjetër s’qenë veçse baballarët tanë.

Shumë shkronjës si Plutarku, Demosteni dhe Straboni
Me shokët e tyre thonë se ngahera kombi ynë
Ishte si dhe sot fisnik, trim, hyjnor, i madhërisëm.

Si dhe ne, ata po qenë shqipëtarë të kulluar
Dhe shqiptari këtë emër e ruan, sepse e pat
Në flamur gjithnjë shqiponjën, shenjë force dhe fitorje.

Gjithnjë brenda Shqipërisë dhe Zeus’ i madh banonte.
N’atë të shenjtinë Tomor një tempull të bukur kishte
Dhe gjithë popujtë atje vinin me nderim të thellë,
Që t’i faleshin asaj perëndie shqipëtare.

Sikur të studiosh të urtin dijetar, Aristotelin,
Ptolemenjt’ e plot të tjerë, me kujdes, mirë edhe drejt,
Do mësosh se dhe i madhi Kostandin, pjellë dardani,
Fisit trim e të dëgjuar të shqiptarve i përkiste.

Edhe mbretëresha e grave të ditura të kësaj kohe,
Dora d’Istria, mos vallë s’ish bij’ e Shqipërisë?
Kurrë s’e harroi atdhenë të stërgjyshërve të saj
Dhe shkruan për “alvanitet”, siç i quajnë të huajt,
Sepse, si të huaj, emrin e vërtetë s’ua dinë.

Edhe thellë ndjen për fisin dashurinë më të kthjellët,

I këndon atij virtutet dhe i jep shpresa të vjera.
O sa kombe janë zhdukur si të qenë gjethe vjeshte,
Dhe sa kombe kanë lindur prej të tyreve rrënoja!

Kurr' në shekuj kombi ynë s'ka ndryshuar dhe siç qenë
Ashtu mbetënë vetijat, gjuha, doket e zakonet.
Shqiptari është siç ishte në fillim, i pandryshuar.
Maqedonasit, ilirët e thesprotët e molosët,
Shqipëtar' ishin të gjithë si edhe në ditët tona.

Kurrë dyndjet e të huajve s'arritën të shkatërrojnë
Kombin ton' as gjuhën tonë dhe shqiptarët s'i ndryshuan
Kombësinë dhe zakonet e mënyrën e jetesës.

Veshur përherë me hekur, kordhëtarë ndër beteja,
Ishin gati dhe të vdesin për Shqipëri, mëmën tonë.

Për shqiptarët kurdoherë të huaj kan' qenë grekët,
Edhe sllavët edhe keltët, edhe skitët e romakët.

Gjithë kombet nënë zgjedhë të romakëve u vunë;
Ndërsa shqipëtarët vetëm kanë luftuar hordhitë
E romakëve, si burra, me guxim e gjer në fund.

Sa beteja dhe sa luftra të përgjakshme kanë bërë
Baballarët tanë trima kundër dyndjeve barbare!

Ranë dëshmorë në luftë ata burra të vërtetë
Për mëmëdhethin e dashur, për lirinë edhe për nderë.

U mbyt në gjak mëmëdheu, armiqtë na e shkretuan,
Porse Shqipëria kurrë s'e duroi robërinë.
Askush nuk ka mundur kurrë që ta vërë nënë këmbë
Shqipëtarin e dëgjuar, këtë heroin e botës.

Në kohë paqe, i butë si qengj është shqipëtarin,
Por në luftrat e betejat si luan i tmerrshëm bëhet.
Kur hordhi bishash të egra, që erdhën nga larg, nga Lindja,
Kundër botës u lëshuan edhe vendet po shkretinin,
Që të gjitha mbretëritë edhe kombet u tmerruan.

Bizantinët fanatikë, frikacakë, të pazotë
Për postin që kanë pasur, nuk u kundërshtuan fare,

Po ranë duke shpresuar në gjëra fyl e pa bukë,
Dhe u bënë ata shkaku i së rëndës robëri.

Turqit, bishat gjakatare, shkatërronjësit e botës,
Porsi ujçer të uritur njerëzve u shqyen zorret.
Perëndimi mbarë dridhej nga të frikëshmit barbarë
Dhe Arusha u kish mbetur e vdekur, pa shpirt në duar.

Asnjeri guxim nuk pati t'i luftonte ato bisha,
Po ndërsa të gjithë ulën qafën nën zgjedhën e zezë,
Një komb vetëm i guximshëm, një komb trim, i papërkulur,
U rreshtua para tyre edhe më t'u kalli dërmën,
Përsëri duke shpëtuar nga rreziqe të llahtarshme
Perëndimin që s'ia diti, të pabesënë Evropë.

Kush qe, vallë, atëherë ai prijësi i kombit,
Ai trimi sypatrembur dhe ajo shqiptonjë mali?
Mos qe Marsi a Minerva, a mos qe Zeusi vetë?

Ti, o muzë gojëartë, që njeh mirë të vërtetën,
Thuaje emërin e ndritur, emërin e perëndijtë,
Këndo, o hyjni fisnike, trimërin' e tij të rrallë.

Lëri mitet e Homerit për Akilin këmbëshpejtë,
Lër Eneun adhuronjë dhe përrallat e Virgjilit,
Se hero i vërtetë tani njihet nga të gjithë,
Është prijsi i shqiptarve, është Skënderbeu i madh.

Lumthi ti, shpirt i pamort! Lumja ti, zemër hyjnore!
Ti, o emër shumë i dashur, emër hyjnor, aq i ëmbël,
Ti je shembull dashurie, ti je monument virtyti,
Manument patriotizmi, trimërie dhe lavdie!

Ty, o bir fisnik, i lartë, i atdheut të shumvojtur,
Shqipëtarët ta nderojnë emërin dhe kurdoherë
E shqiptojnë veç me lotë dashurie dhe respekti,
Se ta njohinë lavdinë, njohin bëmat burrërore.

Kur do vijë vallë dita të të ngrenë monumentin,
Të përgjunjenë me zjarr para këmbëve të tua?
Trimërit' e tua, prijës, dhe fitoret legjendare
Ne, pasardhësit, na mbushin me guxim e burrëri.

Kur ti vdiqe, na ke lënë neve një atdhe të lirë
Dhe e lirë do të jetë Shqipëria jote prapë.
Varri yt siç i ka hije do nderohet mot e jetë.

Nëpër shekuj do të rrojnë emri dhe veprat e tua.

Pra, vraponi, o miq të mi, mëmëdhetarë vraponi,
Me një qëllim, një dëshirë, përpara për Shqipërinë!

O vëllezër shqipëtarë, o ju bij të mëmëdheut,
Ne të gjithë një komb jemi, një gjak, një fis e një farë,
Të gjithë të njëjtit shpirt e të njëjtës zemër jemi,
Ne kemi të njëjtat ndjenja dhe të njëjtën gjuhë flasim,
Ne nuk jemi kurrsesi as turq, as grekër, as sllavë,
Jemi vetëm arbërorë, shqipëtarë zemërtrima,
Dhe ky emër i nderuar, i lavdishëm është ngahera.

Kush s'nderon kombin e vet, ai është i ndyr, i poshtër,
Ai është gënjeshtar, është tradhëtor i ulët.

Mjer' ai që i jep puthjen e tradhtis' kombit të vet,
Mëmëdheut dhe të birit të të lartit zot në qiell!
Deri kur, o miq të dashur, do mundin këta të huaj
Të na kthejnë ne në kafshë me atë shkopin e Çirçës?
Deri kur për interesat e të tjerve do punojmë?
Pse të tjerve t'u shërbejë gjith kjo mendje e trimëri?
Mjerë ne! pse për të huajt kaq flijime e vetmohim?

O sa vepra madhështore kanë bërë shqipëtarët,
Por më kot, se të dobishme qenë vetëm për të tjerë!

Ne, medet, vam' u shërbyem turqëve, vrasësve tanë,
Bishave t'egra mongole, që veç dëm na kanë prurë!

O miq, gjaku i shqiptarit është derdhur kurdoherë
Që të rrojnë ata përbindsha, ata turq shkatërrimtarë.
Sa tmerr të ndihmosh armiqtë e atdheut tënd të dashur!
Dhe një gjë të till' e bënë kaqë burra të dëgjuar!

Cilët qenë ata që jetë shtetit të turqve i dhanë?
Qypriylinjtë dhe të tjerë të gjith' ishin shqipëtarë.
Shqipëria ime e dashur, mëmëdheu im i shtrenjtë,
Të kesh kaq burra në zë dhe të jesh akoma skillave!

Ti të kesh Mehmet Alinë dhe Ibrahimin me shokë,
Ata të shpëtojnë Egjiptin dhe ti të tiranizohesh!

Ç'fat i mjer', i mallëkuar, oh çfarë mynxyr' e zezë!

Të kesh Boçarin, Xhavellën, Miaulin, Bubulinën,
E shumë heronj të tjerë, dhe ata të mos përpiqen
Për ty, Shqipëria ime, po për grekët e Greqinë!
O heronj të paharruar, u munduat kot së koti,
Me të shenjtin gjakun tuaj, me armët tuaja të lara,
Me atë gjuhën e shenjtë flaku zgjedhën tej Greqia.

Ju si burra të vërtetë me zell e me zjarr luftuat,
Po, për fatin ton' të keq, përfituan ca të tjerë.

Dhe u shojtën për së dyti shpresat tuaja të shenjta.
N'atë vend që ju, o trima, e çliruat aso kohe,
Erdhën lajkësit e turqve, bizantinë dhe romej,
Fanarjotë dhelparakë edhe kalemxinj të ulët,
Komb' i lirë, çobaxhinjtë nga qenë edhe nga s'qenë,
Me fjalë të tjera grekët, ata miqtë tan' të mirë,
Dhe ju quajtën të huaj, ju thanë "palarvanites".

Dhe ata mosmirënjohës, o sa keq, gërmuan varret
Dhe shpërndanë nëpër rrugët eshtrat tuaja të shenjta.

Vetëm rastësisht një herë ata shprehën të vërtetën
Se vërtet jeni shqiptarë dhe porsit të huaj jeni.

Të ushqesh në gji një gjarpër të helmuar, të pabesë,
Dhe të bëjë çmos ngahera si e si të të helmojë.

Ç'doni ju nga Shqipëri? Grekër, me siguri doni
Që të vrisni djemt' e Piros fshehurazi me një tjegull.

Po të rremat, djallëzitë, asnjëherë s'japin fryte.
Gjer më sot, më thoni, vallë, sa bullgar' u bënë grekër?
Kush kërkon që të këmbejë kombësin', gjuhën e mëmës,
Të mohoj' atdhenë, ndjenjat, ai do të jetë kafshë.

Si? Ju duket e arsyeshme, o filiza të Sokratit?
Dhe a është, vall', e mundur të harrojë komb' i tërë
Gjuhën e tij amëtare, t'i humbasë që të gjitha?

Fjalët ua mbuloft' harresa, posht' e rrema, djallëzia!
Ju kë quani si trima patriotë, kë nderoni,
Miltiadhn', Themistoklinë, Qimonin, Epaminondën,
Apo Pausanin' e ndyrë, Efialtin e pacipë?

Djallin që tradhton atdhenë nuk e do as mëma vetë.
A nuk është mëmëdheu më i dashur, i nderuar,
Nga çdo gjë e mir' në botë, nga prindët e farefisi,
Nga fëmijët dhe nga miqtë? A ka ndjenjë më fisnike
Se ndjenj' e atdhetarisë edhe se ndjenj' e lirisë?

Si? Qenkemi ne grekër? Jo, më falni! Jemi vetëm
Alvanitër, miq të dashur, jemi vetëm shqipëtarë.
Çdo gjë tjetër është sharje, fyerje dhe blasfemi.

Të ndërrojmë emrin tonë kombëtar? Mos qofë thënë!
Ashtu si fjala grek është për ju e shtrenjtë, e dashur,
Dhe për ne fjala shqiptar është e shenjtë dhe e çmuar.

Nëse thoni që edhe ju jeni, gjithashtu, pellazgë,
Dihetë se pellazgjikë janë kaq e kaq kombe:
Italianët e francezët dhe psanjollët e të tjerë.
Pra, ju jeni italianë? Mos ju quajtën francezë?
Po, të gjithë jemi pjellë të Adamit e të Evës.
Porse çdo njeri një kombi i takon dhe një detyrë
Është e shenjtë dhe hyjnore: "Të luftojë për atdhenë!"
Jeni, thoni, të krishterë. Shumë bukur. po mos vallë
Duhet që çdo i krishterë të jetë dhe grek pa tjetër?

Evropainët që të gjithë janë, dihet, të krishterë,
Po nuk janë aspak grekë dhe as ndjenja greke kanë.
As Krishti as apostojtë s'kanë qenë kurrë grekë.

Kombësin' e Jezu Krishtit që të gjith' e dinë mirë.
A, qenkeni ortodoksë. Shumë bukur. Po dhe rusët
Dhe të gjithë sllavët rrotull gjithashtu jan' ortodoksë.
Dhe ata ndaj fesë, ndofta, mund të jenë më besnikë,
Atëherë përse grekët nuk janë asfare sllavë?

Po atë besim e kishë kanë dhe grekët dhe sllavët,
Dhe, madje, armëtë sllave, mbrojtja dhe kujdesi i tyre,
Në çdo rast ndihmuan grekët sa u dhan' e Thesalinë.

Po në vend që miq me sllavët të jenë, paskëtaj, grekët,
Në të kundërt, jan' armiq dhe armiq të përbetuar,
Sepse dridhen se mos sllavët dhe ata i bëjnë sllavë.

Pra, o miq të dashur grekë, ju të krishterë të mirë,
Krishti tha: "Mos ia bëj tjetrit, atë që s'e do për vete!"
Atë që ju keni frikë se mos jua bëjnë sllavët,
Pse kërkonin kaqë fort shqipëtarëve t'ua bëni

Me gënjeshtër dhe intriga? Feja urdhëron: "Të duash
Dhe të afërmin si veten", ndërsa ju të gjith' i ndiqni.

Ju akoma keni grekër që në robëri rënkojnë
Dhe të tjera kombe doni vetë ju t'i robëroni?
Cilin? Këtë shqipëtarin? Këtë fatosin e dheut?
Edhe kur, në këtë shekull? Në këtë epokën tonë?

A e doni miqësinë edhe dashurinë tonë?
Hiqni dorë nga sofizmat, nga gënjeshtër, nga mashtrimet.
Ne, o miq, jemi shqiptarë, ju helenë: Shqipërinë
Kemi ne dhe ju Helladhën; gjuhën tuaj ju, ne tonën.

Kështu vetëm mund të lidhet miqësia e vërtetë,
Ne me sllavët e me grekët, me të gjithë fqinjët tanë,
Duam të rrojmë ngaherë me harmoni, si vëllezër,
Veç e drejta e secilit gjithënjë të respektohet.

Sot tiranin e pret vdekja, pra nuk duhet të luftojmë
Si armiq me njëri-tjetrin; miq të jemi, në një mendje,
Mjaft kaq vuajtje që shkuam, mjaft kjo tirani e zezë,
Pa të marrimë sot frymë dhe lirinë të gëzojmë!

Poshtë, pra, trazirat, grindjet, rroft' e qoftë vllazëria!
Nëse rrojnë disa grekë brenda Shqipërisë, vallë
Mos janë pak shqipëtarët që brenda Greqisë rrojnë?

Edhe shumë shqipëtarë rrojnë në viset me sllavë.
Poshtë duart, ju o sllavë, larg ju, larg nga Shqipëria!

S'ju arrijnë ato vise të paana të Skitisë?
Shqipëria shqipëtarve u takon, o miq të dashur,
Dhe askush nuk ka të drejtë që të kundërtën të thotë.

Nëse doni që të kemi dashuri mes nesh përherë,
Jetën të çojmë si fqinjë në mirëkuptim e paqe,
Edhe ne po këtë gjë shumë, o miq, e dëshirojmë.

Po në qoftë se ju doni të rrëmbeni trojet tona,
Atëherë, mos nuk është vdekja fundi i njeriut?
Zjarrin, pra, dhe le të digjet gjithë bota, anembanë!
Po të jetë se humbasim ne atdhen' e dashur tonin,
Qielli le të përmbysset, me të edhe perënditë!
O, ju dashkeni që vendin e gjigantëve të zini,
Të atyreve që mundën e shfronësuan hyjnitë?

Ju, o fqinjët tanë, dhe ti o diplomaci dinake,
Binduni njëher' e mirë dhe pa pikën e dyshimit,
Se shqipëtari atdhenë s'ia dorzon askujt e kurrë.

Ju atdhetarinë e tij duhet ta keni provuar;
Atë nuk e mposhtën shtete sado të mëdha, të forta,
Bizantinët e romakët, venedikasit e turqit,
Dhe na dashki që taninë para jush të gjunjëzohet?

Poshtë duart, që të jemi miq të mirë përngahera!
Mbi një mal' të lart' më shfaqet hieja e Skënderbeut,
Shpatën zhveshur mban në duar dhe dëgjoj një zë gjëmonjës,
Që me burrëri të madhe dhe duke rënkuar, thotë:
O djema të mir, ku jeni, ju o burra shqipëtarë,

Ju petrita zemërtrima të atdheut kaq të dashur,
Varrin tim vazhdojn' akoma të huajtë të ma shkelin.
Turp për ju, sa turp, o burra, të lëngoju' atdheu juaj!
Kudo hieja fanitet edhe malet po gjëmojnë.

Befas lart, që nga Tomori, një rrufe lëshon Zeusi
Dhe për gjithë gjakatarët gati zhdokjen e sigurtë.

Miq' e mi, mendohi mirë, të mos biem në lathime,
Se të gjithë, po lathitëm, do ta humbasim shpëtimin.

Perëndi, ndriçoji popujt, sill ti paqen në mes tyre
Edhe ndihni të fitojnë lirin' e shtrenjtë të gjithë.

Solomon, mos ma pre foshnjën, mos e pre, n'emër të zotit,
Le të mbetet pjella ime e paprekur, pacenuar.

Dhe ju, perëndi të qiellit, ju o perëndi të paqes,
Jepjani mollën e sherrit drejtësisht kujt i takon.

O vëllezër arbërorë, shqipëtarë zemërtrima,
Të kaluarën e shihni, gjithashtu edhe të sotmen,
Po sakaq na lipset shumë të kujdesemi për nesër.

Të kujdesemi për gjuhën, për mësimin, mbrothësinë,
Për shpëtimin tonë, nderin, për lavdin' e kombit tonë,
Se ky shekull, o vëllezër, është shekulli i dritës,
Dhe pa gjuhën e pa shkencën, pa shkollën e mbrothësinë,
Pa të mjafta dituri, sot asgjë nuk vlen në botë.

Pra, përpara, o vëllezër, ja se ku qëndron shpëtimi!
Ne kemi një komb të zgjuar, trim e që vështron përpara,
Edhe gjuha jonë mundet të punohetë paprerë.

Ne rrugën e mbarësisë mund ta ndjekim fare lehtë.
Pra, ç'na duhet, o vëllezër? Dashuri, bashkim, përpjekje,
Mençuri, barazi, punë, vëllazëri, një dëshirë,
T'i shërbejmë mëmëdheut me besnikëri gjithmonë,
Çdo kujdes, çdo gjë e mirë t'i blatohet Shqipërisë,
Për atë të të bëhet vetëm, për vëllezrit shqipëtarë.

Ne jemi një komb të gjithë, jemi bijt' e një atdheu,
Një trup jemi dhe një zemër, jemi një fis e një farë,
Kemi një ide, një gjuhë, një palë doke e zakone
Dhe, së fundi, që të gjithë sot ne jemi në një mendje
Për të mirën e përbashkët, për lavdin' e Shqipërisë.
Një perëndi që të gjithë kemi dhe të njëjtën besë,
Pa, secili, si të dojë le t'i falet perëndisë.

Që të gjitha fetë kanë veç një themel të përbashkët,
Ndërsa themel i themelit është vetëm njerëzimi,

Fjalëve t'armiqve t'egër kurrëmos u vini veshin,
Se ata duan gjithmonë me intriga të urrejtshme,
Me çdo mjet ta bëjnë fenë vegël të shkatrrimit tonë,
Ata duan të na ndajnë për të tyret interesa.

Duhet mbi çdo gjë, pa tjetër, kombësia të fitojë.
Në një kohë, në mesjetë, një ndikim të madh ushtronin
Barbaria, fanatizmi, errësira e padija.
Atëherë ne luftuam pa qëllim e kot së koti,
Për të huajt, për armiqtë e kombit, të mëmëdheut,
Porse sot më kot mundohen të huajt të na gënjejnë.

Shqipëtari mendjemprehtë kurrë më nuk do të mashtrohet
Dhe s'ka nge që të djersijë, të coptohet për të tjerë.
Çështjeve, siç është feja, sot me sot u kaloi koha,
Ajo sot është në zemër, në ndërgjegjen e secilit.
Feja e kohës së sotme është vetëm njerëzimi.

Hapësira e paanë është tempull i Krijuesit.
Natyra gjith' anembanë është libri i tij i shenjtë
Dhe shkronja të atij libri janë trupat qiellorë.
Ndërsa si meshtar në tempull është shkenca, që njeriun

E afron tek perëndia, q'është gjithëçka në botë.

E të madhit zot fytyrë është drita që shikojmë
Dhe njeriu është korë edhe shëmbëlles' e zotit.

Zemëra e tij e pastër është fron' i perëndisë
Edhe vetëdija e tij një gjykatës brenda vetes;

E shpërblen për çdo të mirë, e mundon për çdo të keqe.
Sidoqoftë, gjithsekush çdo besim ta respektojë,
Fen' e tij dhe fen' e tjetrit; të mos bëjë dallim feje,
Sepse është e nderuar ajo që nderon dhe tjetri,
Sidomos çka respekton vëllai, djal' i mëmës sate,
Që një gjak keni në deje, që ka shpirtin, gjuhën tënde.

Është e shenjtë dhe hyjnore çdo gjë që beson njeriu,
Çdo gjë që beson një popull dhe një shoqëri e tërë.
I mësuari, i urti është besimtar, po s'është
Fanatik dhe për besimet mendon pa paragjykime,
Ai s'është gojëprishur, egoist, rrugaç, mashtrues.

Mbarë bota flet për Besën dhe për nderin e shqiptarve.
Për vetitja, vllazërimin, harmoninë, miqësinë,
Dashurin', afetarizmin, kombësinë, urtësinë,

Trimërinë dhe kujdesin për të mirën e atdheut.
Bota mbarë u nje prirjen për liri, dituri, dritë.

Kështu, pra, çdo atdhedashës e ka zemërën plot shpresa,
Dhe me ne është përherë perëndia zemërbardhë.
Gjuha jonë, dituria, do të sjellin mbarësitë
E atdheutë fisnik, vllazërimin dhe lirinë,
Mirësitë, begatinë, vetë shekullin e artë,
Dhe, së fundi, sigurojnë qenien tonë në mes botës.
Ato do t'i japin dërrmën çdo armiku e tirani
Dhe në majën më të lartë do ta ngrenë ne, shqiptarët.

Rroftë, rroftë gjuha jonë! Rroft' e qoftë Shqipëria!
Rroftë kombi yn' në shekuj! Rroftë vllazërimi ynë!
Poshtë armiqt' e tiranët! Poshtë grindja, errësira!
Rroftë Besa dhe liria! Rroftë drita, dituria!